



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Raporti vjetor për vitin 2019



Prishtinë, Mars 2020

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (38) 240 252
Fax: +383 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

HYRJE

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, mbibazën e kompetencave dhe përgjegjesive Ligjore respektivisht të Ligjit për Miniera dhe Minerale nenit 57 pika 1, ka përgatitur Raportin për Kuvendin e republikës së Kosovës, mbi punët e kryera gjatë vitit 2019. raporti përmban një:

- analizë të gjendjes së industrisë minerare në Kosovë; dhe
- përmbledhje të të gjitha masave rregullatore, hetuese dhe zbatuese të marra nga KPMM gjatë vitit 2019; megjithatë, ky raport nuk përmban të dhëna lidhur me hetime të cilat janë në vazhdim e sipër, nëse këto të dhëna do të kërcënonin sekretin legjitim të hetimit.

Qëllimi i përgjithshëm i LMM-së përkatësisht i KPMM-së si zbatuese e ligjit është promovimi në përputhshmëri me standardet e pranuar mjedisore, i hulumtimit, nxjerrjes dhe pasurimit të mineraleve përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimi dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore në funksion të zhvillimit ekonomik për të mirën e Republikës së Kosovës. Ky raport prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e realizuar në bazë të këtyre qëllimeve, brenda vitit 2019.

Raporti i punës, përmban punën dhe aktivitetin e bërë në fushën e gjeologjisë - hulumtimit, xehetarisë - shfrytëzimit, përpunimit dhe pasurimit, rezultatet e arritura gjatë vitit, problemet dhe sfidat me të cilat është ballafaquar ky rregullator gjatë punës së vet, si dhe objektivat e parapara për të ardhmen.

Përveç gjërave që u cekën më lartë, raporti i punës i KPMM-së për vitin 2019 synon të përfshijë brenda vetes edhe punët të cilat janë kryer, mbi bazën frymës së rekomandimeve të dala gjatë vlerësimit të raportit paraprak të KPMM-së nga Komisioni Për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktur, Tregëti dhe Industri i Parlamentit të Republikës së Kosovës, e të cilat ishin shumë domethënëse sa i përket përmirësimit të klimës së investimeve në këtë sektor duke përmirësuar strukturën ligjore dhe duke harmonizuar mospërputhjet ligjore ndërinstitucionale. Inkurajimi dhe bashkërendimi me të gjitha institucionet tjera shtetërore për parandalimin dhe ndalimin e ekonomisë joformale. Ngritja e nivelit të analizës lidhur me të arriturat dhe sfidat për rregullimin e këtij sektori dhe zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Ky raport është organizuar mbi bazën e standardeve të formatuara për raportim në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ka këtë përmbajtje:

Përmbledhja ekzekutive, e cila përshkruan në tërësi raportin dhe jep një pasqyrim të përgjithshëm të punës së Institucionit;

Baza Ligjore, në të cilën është e listuar gjithë baza ligjore që rregullon funksionalitetin e institucionit, si dhe vështirësitë ligjore në zbatimin e përgjegjësive të veta;

Përshkrimi i Institucionit, e cila përmban përveç tjerash misionin, vizionin, qëllimin dhe kompetencat e KPMM-së, të parapara me Ligjin e Minerave dhe Mineraleve, po ashtu përshkruan organizmat me përgjegjësi kryesore në punën e KPMM-së;

Organizimi Institucional, është pjesa në të cilën paraqiten format dhe mënyrat e organizimit të brendshëm, në veçanti përmban të dhëna për Bordin, ekzekutivin dhe personelin e KPMM-së në përgjithësi.

Përshkrimi i fushës që e mbulon KPMM, me rëndësi të veçantë, krahasimin e realizimit të planeve, veprimeve të ndërmarra dhe sfidat e tejkaluara dhe të planifikuara për të ardhmen.

Puna gjatë vitit paraprak, ku janë të fokusuara punët specifike të realizuara gjatë vitit 2019, si dhe sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak.

Raporti financiar, ku është prezantuar buxheti dhe shpenzimet për vitin 2019, i shpalosur me detaje shpenzimet dhe te hyrat sipas kategorive dhe aktiviteteve të caktuara;

Raportimi rreth komenteve nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ku janë të prezantuara komentet e ZKA-së dhe adresimi i tyre nga menaxhmenti i KPMM-së, për raportin e auditimit të vitit paraprak; dhe

Anekset, është pjesa e fundit e cila përmban të dhëna shtesë te prezantuara në forma të ndryshme të përshtatura sipas natyrës dhe qasjes së informatës ose të dhënës.

Vlen të theksohet se edhe gjatë vitit 2019, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka intensifikuar aktivitetet në luftimin e ekonomisë joformale, e cila me vite po i krijon probleme të mëdha këtij institucioni, atyre që operojnë në mënyrë legale, ambientit dhe buxhetit të Kosovës në veçanti.

Gjithashtu vlen të theksohet se gjatë vitit 2019 kemi intensifikuar bashkëpunimin me Policinë e Kosovës, duke inspektuar të gjithë territorin e Republikës së Kosovës duke parandalur 194 operatorë të jashtëligjshëm, të cilëve u janë vendosur shiritat dhe ndaluar aktiviteti i tyre. Kurse sa i përket bashkëpunimit me institucionet gjyqësore, në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit të procedimit për rastet e ngritura nga KPMM-ja, rezultatet mbeten edhe më tej të konsiderueshme. Edhe në këtë vit ka vazhduar procesi i aplikimit të procedurave përmbarimore për arkëtimin e borxheve të papaguara nga kategoria e gjobave administrative. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale gjatë vitit 2019 ka organizuar dy takime me perfaqësuesit e ndërmarrjeve të licencuara në KPMM në lidhje me implementimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe aktet tjera nënligjore që i rregullojnë aktivitetet minerare në Republikën e Kosovës, përkrahjen e ndërmarrjeve minerare për rritjen e prodhimit, kujdesit mjedisor e social dhe shtimit të hyrave për shtetin dhe qytetarët.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale do të vazhdojë me intensitet edhe më të shtuar gjatë vitit 2020, që t'i përkrah dhe mbështes në çdo aspekt të gjitha ato ndërmarrje dhe persona fizik që merren ose pretendojnë të merren me industrinë minerare, njëkohësisht do t'i ndalojë, këshillojë dhe përmirësojë të gjithë ata që bien në kundërshtim me Ligjin dhe rregullat në fuqi për sektorin minerar.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
LISTA E TABELAVE	6
LISTA E FIGURAVE.....	7
SHKURTESAT:.....	8
1. PËRMBLIDHJE EKZEKUTIVE	9
1.1. THEMELIMI.....	9
1.2. TË ARRITURAT	9
1.3. OBJEKTIVAT	11
1.4. ANALIZË E GJENDJES SË SEKTORIT MINERAR NË VEND.....	11
1.5. SFIDAT NË TË ARDHMEN	14
2. KORNIZA LIGJORE.....	15
2.1. KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE	15
2.2. AKTET NËNLIGJORE TË NXJERRURA NË KPMM GJATË VITIT 2019.....	15
2.3. VËSHTRËSITË ME TË CILAT ËSHTË BALLAFAQUAR KPMM GJATË VITIT 2019.....	16
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	17
3.1. VIZIONI.....	17
3.2. MISIONI.....	17
3.3. FUSHËVEPRIMI I KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE	17
3.4. KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KPMM-SË	17
3.5. PËRGJEGJËSITË KRYESORE PËR MENAXHIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NË KPMM	18
4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON KPMM.....	19
4.1. ORGANIZIMI, VEPRIMTARITË, PERSONELI DHE NIVELI I RROGAVE.....	19
4.2. BORDI.....	19
4.3. EKZEKUTIVI.....	19
4.4. BURIMET NJERËZORE	19
4.5. ASETET E KPMM-SË	21
4.6. LOKACIONI I KPMM-SË DHE HAPËSIRA FIZIKE E OBJEKTIT	22
5. AKTIVITETET PËR PERIUdhËN RAPORTUESE	23
5.1. SHQYRTIMI DHE LICENCIMI	23
5.1.1. <i>Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)</i>	25
5.1.2. <i>Licencat e shfrytëzimit</i>	27
5.1.3. <i>Lejet për Aktivitete të Veçanta</i>	28
5.2. RËNDËSIA E RESURSEVE MINERARE PËR VENDIN	29
5.3. ANALIZË E REALIZIMIT TË PRODHIMTARISË SË LËNDËVE MINERALE.....	30
5.3.1. <i>Realizimi i prodhimit për lëndë minerale energjetike</i>	30
5.3.2. <i>Realizimi i prodhimit për lëndë minerale metalore</i>	31
5.3.3. <i>Realizimi i prodhimit për lëndë minerale jo metalore</i>	33
5.4. AKTIVITETET E RIKULTIVIMIT DHE MBYLLJES SË MINIERAVE/GUOREVE NË VITIN 2019.....	36
5.5. PLANIFIKIMI DHE NEVOJAT PËR VITIN 2020 - SIPAS LËNDËVE MINERALE	39
5.5.1. <i>Analizë e problemeve në planifikimet vjetore në sektorin minerar</i>	39
5.6. PLANIFIKIMI I PRODHIMIT PËR LËNDË MINERALE ENERGJETIKE	39
5.7. PLANIFIKIMI I PRODHIMIT PËR LËNDË MINERALE METALORE.....	40
5.8. PLANIFIKIMI I PRODHIMIT PËR LËNDË MINERALE JO METALORE.....	41
5.9. PËRMBLEDHJE E PLANIFIKIMIT SIPAS GRUPIMIT TË LËNDËVE MINERALE	42
5.10. INSPEKTIMI DHE MONITORIMI I AKTIVITETEVE MINERARE	43
5.10.1. <i>Organizimi i Inspektoratit</i>	43
5.10.2. <i>Zhvillimi i aktiviteteve minerar në KEK</i>	44
5.10.3. <i>Sasia e eksplozivit e përdorur gjatë vitit 2019</i>	46
5.10.4. <i>Mbrojtja dhe siguria në punë</i>	46
6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET	50
6.1. PARANDALIMI DHE NDALIMI I OPERIMEVE TË JASHTËLIGJSHME DHE NGRITJA E KUALITETIT DHE SIGURISË NË PUNË.....	50
6.1.1. <i>Bashkpunimet me Institucionet e vendit:</i>	50

6.1.2.	<i>Sfidat që na kanë përcjellur gjatë vitit 2019</i>	<i>50</i>
6.2.	NGRITJA E KUALITETIT DHE SIGURISË NË PUNË NË OPERIMET MINERARE	52
6.3.	MOSTRAJTIMI NË KOHË I LËNDEVE TË PARAQITURA NË GJYKATA.....	53
7.	RAPORTIMI FINACIAR.....	54
8.	RAPORTIMI RRETH KOMENTEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	65
9.	SHTOJCAT	67

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Inspektimet e realizuara gjatë vitit 2019.....	10
Tabela 2: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë vitit 2019.....	15
Tabela 3: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2019.....	21
Tabela 4: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2019.....	25
Tabela 5: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	26
Tabela 6: Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	26
Tabela 7: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale.	27
Tabela 8: Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2019 për aktivitete të veçanta	29
Tabela 9: Gjendja e rezervave minerale metalore në vendburimet e licencuara gjatë viteve 2016-2019.....	32
Tabela 10: Gjendja e rezervave të mineraleve jo metalore në vendburimet e licencuara 2016-2019.....	33
Tabela 11: Ri kultivimi dhe mbyllja e minierave/gurore gjatë vitit 2019.....	37
Tabela 12: Planifikimi i shfrytëzimit të rezervave minerale energjetike për vitin 2020.....	39
Tabela 13: Planifikimi i shfrytëzimit të rezervave minerale metalore për vitin 2020	40
Tabela 14: Planifikimi i shfrytëzimit të rezervave minerale jo-metalore për vitin 2020	41
Tabela 15: Planifikimi i prodhimit të lëndëve minerale energjetike vitin 2020	42
Tabela 16: Planifikimi i prodhimit të lëndëve minerale metalore për vitin 2020	42
Tabela 17: Planifikimi i prodhimit të lëndëve minerale jo-metalore për vitin 2020.....	42
Tabela 18: Planifikimi dhe realizimi i qymyrit Janar-Dhjetor 2019 (në ton)	44
Tabela 19: Planifikimi dhe realizimi i djerrinës (mbulesës) për periudhën Janar – Dhjetor 2019 (m3).....	45
Tabela 20: Minimet speciale të realizuara gjatë vitit 2019 :.....	46
Tabela 21: Aksidentet - lëndimet në punë në miniera gjatë vitit 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019 sipas llojit të lëndimeve	47
Tabela 22: Aksidentet - lëndimet në punë në miniera, gurore, objekte minerare gjatë vitit 2019.....	47
Tabela 23: Buxheti i aprovuar në fillim të vitit 2019	54
Tabela 24: Buxheti pas rishikimit për vitin 2019	54
Tabela 25: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2019	55
Tabela 26: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2019.	56
Tabela 27: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mallra dhe shërbime në vitin 2019	58
Tabela 28: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitetin për vitin 2019.....	59
Tabela 29: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2019	59
Tabela 30: Krahësimi i shpenzimeve për vitet 2019-2016.....	60
Tabela 31: Vizitat jashtë vendit që janë realizuar në vitin 2019.....	61
Tabela 32: Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.	61
Tabela 33: Inkasimi dhe depozitimi i të hyrave për vitin 2019	62
Tabela 34: Planifikimi i të hyrave për vitin 2019 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2019	63
Tabela 35: Inkasimi i të hyrave për vitet 2019-2016:.....	63

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Inkasimi i të hyrave per vitet 2016-2019	9
Figura 2. Raporti i licencave të hulumtimit dhe shfrytëzimit	12
Figura 3. Numri i licencave të mineraleve ndërtimore dhe industriale	12
Figura 4. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së	19
Figura 5. Organogrami i KPMM-së për vitin 2019	20
Figura 6. Lokacioni i KPMM-së	22
Figura 7. Pranimi i aplikacioneve sipas muajve	23
Figura 8. Numri i aplikacioneve të pranuar, gjatë viteve 2015-2019	24
Figura 9. Numri i licencave dhe lejeve të lëshuara, gjatë viteve 2015-2019	24
Figura 10. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2019	25
Figura 11. Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	26
Figura 12. Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	27
Figura 13. Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale	28
Figura 14. Grafiku i lejeve të lëshuara për vitin 2019 për aktivitete të veçanta	29
Figura 15. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme minerale energjetike gjatë viteve 2016-2019	31
Figura 16. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzuara të mineraleve energjetike (Linjitit) gjatë viteve 2016-2019	31
Figura 17. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme të mineraleve metalore në vendburimet e licencuara gjatë viteve 2016-2019	32
Figura 18. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale metalore të shfrytëzuara gjatë viteve 2016-2019	33
Figura 19. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme të mineraleve jo metalore 2016-2019	35
Figura 20. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme të gëlqerorit për vitet 2016-2019	35
Figura 21. Diagrami i rezervave të shfrytëzuara të lëndëve minerale jo metalore gjatë viteve 2016-2019	36
Figura 22. Diagrami i rezervave të shfrytëzuara të lëndëve minerale jo metalore (gëlqeror mergel) gjatë viteve 2016-2019	36
Figura 23. Fushat e rikultivuara në ish minierat/guroret	38
Figura 24. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave minerale energjetike (linjitit) për vitin 2020 bazuar në vitet 2016-2019	39
Figura 25. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave minerale metalore për vitin 2020	40
Figura 26. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave minerale jo-metalore për vitin 2020 bazuar në vitet 2016-2019	41
Figura 27. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave për gëlqeror dhe mergelë për vitin 2020, bazuar në vitet 2016-2019	42
Figura 28. Planifikimi dhe realizimi i qymyrit për vitin 2019(në ton)	44
Figura 29. Planifikimi dhe realizimi i djerrinës (m ³)	45
Figura 30. Paraqitja grafike sipas llojit të lëndimeve	47
Figura 31. Paraqitja grafike e lëndimeve sipas punishteve	48
Figura 32. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2019	54
Figura 33. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2019	55
Figura 34. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2019	56
Figura 35. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2019	56
Figura 36. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitë në vitin 2019	59
Figura 37. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2019	59
Figura 38. Krahësimi i shpenzimeve për vitet 2019-2016	60
Figura 39. Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera	62
Figura 40. Inkasimi i të hyrave për vitin 2019	62
Figura 41. Planifikimi i të hyrave për vitin 2019 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2019	63
Figura 42. Inkasimi i të hyrave për vitet 2019-2016	64

SHKURTESAT:

APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
Au, Ag, Ni, Co, Pb, Zn,	Argjend, Nikel, Kobalt, Plumb, Zink, Ari
GIS	Sistemi Gjeografik i Informimit (Geographic Information System)
Gjeo	Gjeologjike
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
LMM	Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158
MAP	Ministria e Administratës Publike
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
Pb-Zn	Plumb-Zink
RKS	Republika e Kosovës

1. PËRMBLIDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Themelimi

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është Agjenci e Pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158 (tash e tutje LMM), me aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LMM-së.

KPMM mbikëqyret nga Bordi i cili përbëhet prej 5 anëtarëve, të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë mandat 5 (pesë) vjeçar. Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori i cili ka mandat 3 (tre) vjeçar. Ndërsa me Inspektoratin udhëheq Kryeispektori i cili ka mandat 5 (pesë) vjeçar. Struktura dhe stafi tjetër i KPMM-së, përbëhet nga departamentet kryesore me staf profesional dhe njësitë tjera mbështetëse me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në KPMM gjatë vitit 2019 ishte 76 të punësuar, nga 80 të aprovuar.

1.2. Të arriturat

KPMM është organi përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare, taksën dhe gjobën administrative. Në vitin **2019** neto të inkasuara janë **30,453,799.69 €**. Në figurën e mëposhtme mund të shikoni trendin e realizimit për të hyrat nga viti 2016 deri në vitin 2019.




Figura 1. Inkasimi i të hyrave për vitet 2016-2019

- Gjatë vitit 2019 Bordi i KPMM-së ka mbajtur 30 takime të rregullta të tij, në të cilat janë shqyrtuar 375 kërkesa për licenca dhe leje (në këtë numër janë përfshirë kërkesat e ndërmarrjeve që janë shqyrtuar më tepër se një herë si dhe disa kërkesa të ndërmarrjeve të pranuar para vitit 2019).
- Gjatë vitit 2019, KPMM ka menaxhuar me **831** licenca dhe leje.
- Pas procedimit të të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi, brenda vitit 2019, janë lëshuar 255 Licenca dhe Leje. Licenca hulumtimi 85, Licenca shfrytëzimi 52, Leje për Aktivitet të Veçantë 118.
- KPMM ka refuzuar për mos përmbushje të kushteve për licencim, 60 kërkesa për licenca dhe leje (Hulumtim 31, Shfrytëzimi 9, dhe Leje për Aktivitet të Veçantë 20).

- Gjatë vitit 2019, lëndë minerare të shfrytëzuar sipas kategorive janë: Minerale Metalike Pb-Zn (204,079.00 ton), Ni-Co (305,012.48 ton), Minerale energjetike (lignit) 8,063,051.00 ton.
- Inspektorati i KPMM-së gjatë vitit 2019 ka pasur një dinamikë të lartë pune të vizitave ose inspektimeve në terren. Gjatë kësaj periudhe janë realizuara **2359** vizita, gjegjësisht inspektime në terren. Këtë numër e përbejnë:

Tabela 1: Inspektimet e realizuara gjatë vitit 2019

Lloji i inspektimit	Numri
Kërkesat për minime masive	606
Lejet për minime masive	540
Numri i përgjithshëm i inspektimeve të përbashkëta sipas planit operativ	505
Ndërmarrjet e shirituara me urdhër për ndalim të veprimtarisë minerare	194
Aplikacionet e pranuar në KPMM të ndërmarrjeve pas vizitave gjatë planit operativ	58
Raporte të operimit të jashtëligjshëm pas ri inspektimit	27
Raporte të operimit të jashtëligjshëm për vitin 2019	50
Sekuestime të kamionetave me qymyr	13
Inspektimet ditore	514
Inspektimet e rregullta vjetore – vizita në terren	46
Total	2359

- Në këtë vit janë përcjell **47** kallëzime penale në Prokuroritë kompetente, në bazë të raporteve që kanë ardhur nga terreni, për operime pa licencuara dhe janë në procedure të shqyrtimit nga gjykatat kompetente;
- KPMM gjatë vitit **2019** ka përgatitur **54** Aktvendime për Gjoha administrative lidhur me operimet e pa licencuara, duke respektuar ligjet dhe normat ligjore në fuqi;
- Gjatë vitit 2019 nga KPMM-ja janë verifikuar se janë përmbush kushtet për lëshimin e Propozimeve për përmbardim të përmbarduesit privat, **110** Propozime për Përmbardim;
- Duke pasur parasysh ndryshimet që kanë qenë pas ndarjes së buxhetit fillestar, buxheti i aprovuar ose final i KPMM-së për vitin **2019** ishte **1,301,942.47 €**, përderisa i realizuar është **1,265,209.07 €**, ose **97.18%** e buxhetit final.
- KPMM gjatë vitit 2019 ka vazhduar ta plotësojë kornizën ligjore duke nxjerrur edhe 7 akte nënligjore.
- Në kuadër të Planit të Veprimtari për parandalimin dhe ndalimin e aktiviteteve minerare të jashtëligjshme, KPMM gjatë vitit 2019 ka bashkërendis aktivitetet me shumë institucione tjera lidhur me një menagjim më të mirë të sektorit minerar, duke përfshirë këtu të gjitha inspektoratet e komunave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, Policinë si dhe me Prokuroritë dhe Gjykatat e vendit.
- Gjatë vitit 2019 janë organizuar dhe mbajtur dy takime të KPMM-së me ndërmarrjet Minerare, për të prezentuar të drejtat dhe detyrimet ligjore dhe procedurale në përputhje me aplikacionet, licencat dhe lejet.
- Përveq tjerash KPMM, kapasur edhe aktivitete tjera të rëndësishme si;
- Takime të KPMM-së me përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Angleze, Hungareze, Kanadeze, Bankës Botërore,

- Takimet e KPMM-së me Ministrin e MZHE-së, përfaqësime të KPMM-së në Komitetin Ndërmënytor, takimet në Kryeministri për problemet e KEK-ut dhe për Trepçën.
- Pjesëmarrja e KPMM-së në Grupet e punës për hartimin e Ligjit të ri për Miniera dhe Minerale.
- Gjate pjesmarrjes së KPMM-së në PDAC, së bashku me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik z. Lluka dhe deputeten e Kuvendit të Kosovës znj. Shala, kemi pas rastin të jemi pjesë e takimeve të organizuara nga konsullata e Kosovës në Toronto, si me përfaqësues të Bizneseve Kanadeze të sektorit Minerar e po ashtu edhe me Përfaqësuesit e Rrjetit të bizneseve Shqiptare në Kanada.

1.3. Objektivat

KPMM, parasheh që të rris efikasitetin dhe efektivitetin e detyrave dhe përgjegjësi të veta përkatësisht llogaridhënjën duke ngritur dhe avancuar në vazhdimësi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes në përgjithësi dhe duke zbatuar objektivat e caktuara në veçanti:

- Implementimi i Legjislacionit minerar, politikave dhe strategjisë minerare;
- Licencimi i ndërmarrjeve në harmoni me LMM, me Planin për menaxhimin e resurseve minerale, me Strategjinë minerare;
- Monitorimi – inspektimi i aktiviteteve minerare në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Tërheqja e investimeve duke promovuar zbatimin e ligjit dhe politikave minerare;
- Ngritja e nivelit të transparencës, komunikimit dhe avancimi i sistemit të teknologjisë informative për të mundësuar punë me efikasitet në KPMM.

1.4. Analizë e gjendjes së sektorit minerar në vend

TË ARRITURA, SFIDAT DHE ADRESIMI I TYRE PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR SI BAZË PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Edhe pse, Kosova ka të njohura rezerva të konsiderueshme të mineraleve metalore, energjetike, industriale dhe mineraleve ndërtimore, ende nuk ka gjetur mënyrën më të mirë për valorizimin e tyre, me theks të veçantë mineralet metalore dhe energjetike, gjë e cila duhet të jetë detyrë prioritare e institucioneve tona, që përmes planeve konkrete dhe infrastrukturës ligjore të favorshme, të hapin rrugë zhvillimit të qëndrueshëm të industrisë minerare e përmes saj zhvillimit ekonomik të vendit.

Vazhdimisht është theksuar se sektori minerar është njëri ndër sektorët kryesor për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit, mirëpo edhe përkundër disa të arriturave të vazhdueshme, ende nuk është arritur që ky sektor të kontribuojë në masën e dëshirueshme në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në mendojmë se një zhvillim i qëndrueshëm i sektorit minerar mundë të arrihet duke u bazuar në potencialin që ka Kosova dhe duke u mbështetur në praktikën më të mirë të vendeve që e kanë të zhvilluar këtë sektor.

Në këtë pikë KPMM ka bërë një analizë të shkurtër lidhur me rezultatet e rritura, sfidat dhe zgjidhjen/adresimin e tyre në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Licencat për mineralet metalore

KPMM, edhe pse ka lëshuar **49** licencave për hulumtim të mineraleve metalike, vetëm **4** licenca janë aktive për shfrytëzimin e mineraleve metalike.




Figura 2. Raporti i licencave të hulumtimit dhe shfrytëzimit

Licencat për mineralet ndërtimore dhe industriale

Për dallim nga shfrytëzimi i mineraleve metalike shfrytëzimi i mineraleve ndërtimore dhe industriale ka shënuar një rritje me dinamikë të lartë duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërtimin e vendit. KPMM ka lëshuar **188** licenca për shfrytëzim të gurit të forte dhe **14** licenca për minerale industriale të tjera siç janë; mergelët, argjilat, etj. Trendet edhe pse për momentin janë në rritje edhe për disa vite, në të ardhmen kjo do të ndryshoj pasi që nevojat e vendit për këto materiale do të zvogëlohen, prandaj në këtë fushë duhet shikuar edhe mundësitë e rritjes së eksportit të materialeve ndërtimore të prodhuara në Kosovë.




Figura 3. Numri i licencave të mineraleve ndërtimore dhe industriale

Sido që të jetë, sektori mineral në Republikën e Kosovës punëson rreth **20,000** të punësuar në mënyrë direkte dhe indirekte. Të hyrat në vitin **2019** janë **30,453,799.69 €**.

Në vazhdim do të paraqesim disa nga faktorët kryesor të cilët janë edhe sfida reale dhe kanë ndikimin e drejtpërdrejt në krijimin e stabilitetit të sektorit mineral dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit mineral:

1. Zhvillimi i minierave ne ndermarrjen Trepça SHA.
2. Zhvillimi i Zonave me Interes të Veçantë të shpallura nga Qeveria.
3. Mundësit e shfrytëzimit të mineraleve energjetike – linjtit – mungesa e bazës ligjore adekuate për të nxitur shfrytëzimin e këtij resursi.
4. Nevojat për investime afatgjata në hulumtime për zbulim të zonave të reja të pasura me minerale metalike.

1. Trepça SHA

Siç është e ditur statusi i pa definuar i kësaj ndërmarrje ka qenë pengesë e zhvillimit të saj. Tani pas aprovimit të Ligjit për Trepçën dhe aprovimit të statutit të Trepçes nga Kuvendi i Kosovës, janë krijuar kushtet për zhvillimin e kësaj ndërmarrjeve respektivisht minierave të Trepçës. Prandaj rekomandohet që pa humbur kohë të konstituohen organet qeverisëse të Ndërmarrjes, të bëhen planet programet konkrete zhvillimore të saj dhe të fillohet me investime në minierat e Trepçës, sepse kjo do të ndikojë direkt në zhvillim të qëndrueshëm të sektorit si dhe rritje të zhvillimit ekonomik, punësim dhe të hyrave për Republikën e Kosovës.

2. Zhvillimi i Zonave me Interes të Veçantë të shpallura nga Qeveria

Në vitin 2008 në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale, Qeveria e Republikës së Kosovës ka shpallur 11 Zona me interes të Veçantë. Qëllimi i shpalljes së këtyre zonave ishte zbatimi i procedurave konkurruese dhe gjetja e investitorëve serioz. Këto zona janë zonat me perspektiv më të madhe për zhvillimin e sektorit mineral, mirëpo edhe për kundër perspektivës që kanë, ende nuk kanë filluar të zhvillohen. Kjo ka ndodhur si pasoj e lënies me ligj të përgjegjësisve të shpërndara, procedimi përmes komiteteve ndërministrorë dhe zyrave PPP të cilat në fakt nuk kanë funksionuar.

Duke pasur parasysh se ka kompani serioze të interesuara për këto zona, është nevojë imediate që të fillohet me shpalljen e tyre që të tërhiqen investime direkte në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit mineral. Gjate vitit 2019 Qeveria e Kosovës pati tentuar që permes Ligjit për investimit strategjike të hap kuto zona për investime, mirepo kjo nuk është arritur për shkak se vlera e garancioneve për tu kualifikuar si Investitor strategjik janë cilesuar si shume te larta. Po ashtu duhet të jetë e qartë për Institucionet e Kosoveës se askush nuk do të bllokonte një vlerë prej 3,000,000.00 € si garancion për hulumtime, për derisa nuk ka asnjë siguri të plotë se në këto zona do të gjente vendburime të rezervave të metaleve të cilat do t'i siguronin një të ardhme të sigurtë për afarizëm në sektorin e Minierave.

3. Mundësitë e shfrytëzimit të mineraleve energjetike – linjtit

Mungesa e bazës ligjore adekuate për të nxitur shfrytëzimin e këtij resursi – Me Ligjin për Minierat dhe Mineralet është paraparë që licencat për minerale energjetike të lëshohen përmes një procedure tenderuese që ka rezultuar të jetë shumë byrokratike dhe përveç lëshimit të licencave për linjit me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike nuk është lëshuar asnjë licence tjetër për shfrytëzim të mineraleve energjetike. Për kundër interesimit të kompanive për të shfrytëzuar këtë mineral për qëllime të përpunimit dhe prodhimit të produkteve të tjera. Pa humbur kohë Qeveria duhet që të adreson këtë problem, duke marrur hapa konkret në krijimin e

bazes ligjore te pershtatshme e cila do te krojonte perspektive per shfrytëzimin e linjitet perveq per Energji edhe për qëllime të tjera ashtu siç parasheh strategjia minerare e RKS-së.

4. Nevojat për investime afatgjata në hulumtime për zbulim të zonave të reja të pasura me minerale metalike.

Hulumtimet afatgjate për zbulimin e zonave të reja metalore kërkojnë investime të mëdha financiare. Ne jemi dëshmitarë se sot në botë nga 100 shpime të kryera për kërkime të vendburimeve të reja metalore, konsiderohet sukses nëse njëra prej tyre jep rezultate pozitive. Përpos arritjes së rezultateve në hulumtime nevojitet edhe shpenzim i një periudha kohore të konsiderueshme dhe sigurim i qëndrueshëm i mjeteve financiare për hulumtimin e vendburimeve të reja metalore në një zonë. Iniciativat për harmonizimin e Ligjeve të sektorëve tjerë me Ligjin për Miniera dhe Minerale, është nevojë imediate që të rregullohet njëherë e mirë, në mënyrë që mos të paraqiten barrierat dhe byrokraci të pa nevojshme sa i përket kohës së zgjatjes së licencave dhe sipërfaqeve të tyre. Këtu kemi të bëjmë direkt me kolozionet ligjore sidomos me Ligjin për Pyjet dhe udhizimet administrative qe burojnë prej tij.

1.5. Sfidat në të ardhmen

Duke marr parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me LMM-në dhe rregullativat tjera në përgjithësi, në njërin anë dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për zbatimin e tyre në praktikë në anën tjetër, e kur kësaj i shtojmë edhe konceptet mbi trendet zhvillimore për këtë fushë, mund ta konsiderojmë si sfidë të veçantë për vet institucionet e RKS-së dhe gjithsesi sfidë për vet KPMM-në është bashkërendimi i punes me të gjitha institucionet Ligjzbatuese. Si sfida për arritjen e objektivave të parapara në të ardhmen, ne mund të veçojmë:

- Ngritja e kualitetit dhe sigurisë ne pune ne operimet minerare - Edhe pse funksionimi i sektorit minierar në Kosovë shoqërohet me siguri të mirë, prapë se prapë për Inspektoratin e Minierave mbetet sfidë që në bashkëpunim me institucionet relevante të përvetësojë dhe zbatoj standardet teknike dhe të sigurisë që zbatohen në vendet e BE-së;
- Mostrajtimi në kohë i lendeve te paraqitura në gjykata. Sanksionet Penale të Shqiptuara nga Gjykatat nuk po e arrijnë efektin e preventives në ndalimin e operimeve të jashtëligjshme;
- Parandalimi dhe ndalimi i aktiviteteve minerare të jashtë ligjshme – Edhe pse ka pasur rezultate pozitive gjate vitit 2019 edhe me tutje një ndër sfidat kryesore të Inspektoratit të Minierave, edhe për vitin vijues do të jetë parandalimi i operatorëve të jashtë ligjshëm në sektorin e minierave si dhe sekuestrimi i mjeteve dhe lëndëve minerale të tyre.
- Hartimin dhe aprovimin e akteve nënligjore të nevojshme dhe domosdoshme për implementimin e LMM-së;
- Implementimi i vazhdueshëm i aktiviteteve që rrjedhin nga zbatim i Strategjisë minerare dhe Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale.
- Implementimi i vazhdueshëm i aktiviteteve që rrjedhin nga zbatim i politikave minerare të Qeverisë.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1. Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale

KPMM është themeluar me Rregulloren Nr. 2005/2 që ka hyrë në fuqi me datën 21 janar 2005, e cila është ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-081 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2005/2 të datës 13 qershor 2008, ku përcaktohet si Agjenci e Pavarur në përputhje me nenin 119 paragrafi 5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës .

Veprimtarinë e vet, KPMM-ja e zhvillon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i cili nga data 27 gusht 2010 ka hyrë në fuqi dhe është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Minierat dhe Mineralet i cili është pulikuar në Gazetën Zyrtare me 28 mars 2013, dhe Ligjin për siguri në punë në veprimtarinë minerare Nr. 05/L-062 të nxjerrur në vitin 2016.

KPMM-ja rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra dhe Strategjinë Minerare, e cila vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LMM-së.

2.2. Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë vitit 2019.

Ligji Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet e obligon KPMM-në që të nxjerr akte nënligjore - Udhëzime Administrative me të cilat në mënyrë më të specifikuar rregullohen çështje të caktuara.

Në vitin 2019, nga Departamentin Ligjor në bashkëpunim edhe me departamentet tjera të KPMM-së janë përgatitur 7 Udhëzime Administrative dhe një vendim për Riaplikim që janë publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura Udhëzimet Administrative të nxjerrura në KPMM gjatë vitit 2019.

Tabela 2: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë vitit 2019

Udhëzime Administrative 2019	
1	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 001/2019 - PËR MENAXHIMIN E AUTOMJETEVE TË KPMM-SË
2	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 002/2019 - PËR KRITERET E CAKTIMIT PËR PERSONAT PËRGJEGJËS NË NDËRRMARRJET E LICENCUARA NË KPMM
3	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 003/2019 - PËR MENAXHIMIN E PASURISË JO FINANCIARE TË KPMM-SË
4	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 004/2019 - KODI I SJELLJES DHE ETIKËS NË KOMISIONIN E PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE
5	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 005/2019 - PËR SHPENZIMET MINIMALE TË HULUMTIMIT
6	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 006/2019 - PËR FORMAT STANDARDE TË SINJALIZIMIT TË MINIERAVE
7	UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 007/2019 - PËR DËNIMET ADMINISTRATIVE DHE DËNIMET MANDATORE

2.3. Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPMM gjatë vitit 2019

Punën dhe aktivitetin e KPMM-së gjatë vitit 2019 e kanë përcjellë një mori vështirësi të cilat në raste të caktuara kanë ndërlikuar punën këtij institucioni mjaft të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës.

Mos harmonizimi i ligjeve tjera me LMM-në. Gjatë punës së përditshme në zbatimin e dispozitave ligjore, KPMM ka hasur në vështirësi rreth sigurimeve dhe garancioneve që LMM i ka paraparë për ndërmarrjet e licencuara, kurse më vonë kjo çështje është rregulluar edhe me akte të brendshme – Udhëzime Administrative.

Sipas nenit 70 të LMM-së, Inspektorati i KPMM-së është kompetent për **sekuestrimin** e mjeteve të punës dhe lëndës minerale të operatorëve të pa licencuar që hasen në vendshfrytëzim.

Lidhur me këtë çështje kemi hasur në pengesa nga ana e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, ku me rastin e sekuestrimit të mjeteve të punës, na është kërkuar vendim i veçantë nga gjykata kompetente për të pranuar makineritë e sekuestruara. Kjo çështje është sqaruar me shkrim nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, se nuk ka nevojë për vendim të veçantë nga gjykatat, sepse dispozitat e LMM-së e cekin shprehimisht se është kompetencë e KPMM-së sekuestrimi i mjeteve në rastet e veprimit të pa licencuar.

Problem në vete paraqet edhe çështja e zhvillimit të procedurës ligjore nëpër gjykata duke i lënë lëndët të vjetërsohen si dhe shqiptimi i masave joadekuatë në raport me veprën penale të kryer duke iu shqiptuar denime me kushte për veprimet e pa licencuara, gjë që nuk e ka efektin e duhur ligjor në shumë raste.

Mos harmonizimi i Ligjit për Pyjet e Kosoves me LMM-në, ngase kemi raste kur sipërfaqja që duhet të shfrytëzohet, në kopjen e planit dhe listën poseduese shkruan se kultura është mal, ndërsa APK-ja nuk është pronare e ngastrës dhe megjithëatë kërkohet pëlqim nga APK-ja.

Poashtu, APK-ja lëshohen pëlqime në sipërfaqe maksimale deri në 5 hektarë dhe në kohëzgjatje prej 5 viteve, kurse sipas LMM-së është e paraparë që kohëzgjatja e licencave për shfrytëzim të mineraleve ndërtimore mund të jetë deri 25 vite me mundësi vazhdimi edhe për 25 vite tjera. Kurse, për mineralet energjetike deri në 30 vite me mundësi vazhdimi edhe për 15 vite tjera.

KPMM gjatë vitit 2019, ka bërë 47 kallëzime penale në Prokuroritë përkatëse për ndërmarrjet apo personat fizik që aktivitetin e vet minerar e kanë zhvilluar pa licenca apo leje nga KPMM.

KPMM gjatë vitit 2019 ka përgatitur dhe i ka dërguar në adresat e duhura 54 Aktvendime për Gjyba administrative lidhur me operimet e kundërligjeshme, nga të cilat janë në vlerë prej **511,503.42 €**.

Gjatë vitit 2019 nga KPMM-ja janë verifikuar se janë përmbush kushtet për lëshimin e Propozimeve për përmbardim të përmbarduesit privat, prandaj janë përgatitur dhe janë dërguar për përmbardim 110 Propozime për Përmbardim që në vete përmbajnë shumë aktvendime për Gjyba administrative.

Komisioni shqyrtues i Ankesave i KPMM-se ka mbajtur 22 seanca për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave nga palët e ndryshme që i janë drejtuar KPMM-së.

Sipas evidencës që kemi për vitin 2019 numri i tyre i përgjithshëm është 53 ankesa prej të cilave janë shqyrtuar 50 dhe të tjerat do të shqyrtohen në vitin në vijim.

Janë përgatitur 41 aktvendime mbi shqyrtimin e ankesave pas marrjes së vendimit nga Bordi, ku janë të përfshira edhe disa ankesa të fund vitit 2018 të cilat janë përgatitur në vitin 2019.

Bashkangjitur në raport si shtojca janë listat e kallzimeve penale, gjjobave administrative dhe propozimeve për përmbardim për vitin 2019.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. Vizioni

Krijimi i mjedisit institucional përmes shërbimeve cilesore, për rritjen e shpejte të investimeve në sektorin mineral, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e interesit të komunitetit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

3.2. Misioni

Hulumtimi dhe shfrytëzimi i resurseve minerare, zgjerimi e modernizimi i industrisë së përpunimit mineral për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies për qytetarët e Republikës së Kosovës.

3.3. Fushëveprimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me ligjin për minierat dhe mineralet, aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare.
3. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale.
4. Paraqet vepër penale dhe shkelje të ligjit nëse një person ushtron ose tenton të ushtrojë ndikim politik, administrativ, financiar ose ndikim tjetër në KPMM-në, personelin ose menaxhmentin e saj.

3.4. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e KPMM-së

1. KPMM ka autoritetin e përgjithshëm dhe përgjegjësinë për të siguruar:
 - 1.1. Ligjshmerinë në hulumtimin dhe shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimtaritë minerare në Kosove;
 - 1.2. Pajtueshmëria e operimeve minerare me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me ligjin dhe kushtet dhe afatet e licencave dhe lejeve të lëshuara nga KPMM, apo pëlqimeve të lëshuara si parakusht për miratim nga KPMM, në pajtim me ligj.
2. KPMM ka kompetencën për ushtrimin e funksioneve në vijim, në përputhje me Ligjit për Miniera dhe Minerale:
 - 2.1. lëshimin, transferimin, vazhdimin, pezullimin dhe revokimin e Licencave dhe Lejeve;
 - 2.2. themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një baze të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të dhëna të tjera relevante ekonomike si dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të drejtave minerare; dhe
 - 2.3. nxjerrjen e rregullave për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të KPMM-së;
3. KPMM i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria.
4. Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me Ligjin për Minierat dhe Minerale;

5. KPMM-ja mund të lëshojë këto Licenca dhe Leje pas përmbushjes së kushteve për lëshimin e këtyre Licencave dhe Lejeve në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale:

- 5.1. Licenca për hulumtim;
- 5.2. Licenca për mbajtjen e të drejtave;
- 5.3. Licenca për shfrytëzim;
- 5.4. Leja për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta;
- 5.5. Licenca për shfrytëzim zejtar;
- 5.6. Licenca ose Leja në Interes të Publikut.

3.5. Përgjegjësitë kryesore për menaxhimin e aktivitetit minerar në KPMM

Të gjitha kompetencat e KPMM-së ushtrohen nga Bordi i KPMM-së. Çdo vendim i cili sipas ligjit të minierave kërkohet të merret nga KPMM-ja duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM-së. Përderisa Drejtori i KPMM-së drejton veprimtarinë e zakonshme të KPMM-së dhe ushtron të gjitha funksionet e deleguara nga Bordi i KPMM-së.

Megjithatë, KPMM-ja funksionalizimin dhe realizimin efikas dhe efektiv të kompetencave dhe përgjegjësi të veta e realizon përmes organizmave profesionalë të ngritur në nivele departamentesh. Struktura e KPMM-së përbëhet nga departamentet kryesore dhe departamentet ose njësitë tjera mbështetëse për detyrat dhe përgjegjësitë e KPMM-së.

4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON KPMM

4.1. Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave

Në përputhje me LMM-në, si dhe Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, KPMM e ka të rregulluar strukturën e vet organizative.

4.2. Bordi

KPMM drejtohet nga Bordi ("Bordi i KPMM") i cili përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Të gjitha kompetencat e KPMM ushtrohen nga Bordi. Çdo vendim i cili sipas ligjit kërkohet të merret nga KPMM duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM. Mandatet e anëtarëve të bordit janë pesë (5) vjet. Anëtarët e Bordit nuk e kanë statusin e shërbyesit civil. Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre sipas ligjit, anëtarët e bordit do të veprojnë ekskluzivisht në interes të publikut dhe me mirëbesim. Anëtarët e bordit të KPMM-së emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi i KPMM-së, përveç takimeve të rregullta, me kërkesë të Drejtorit apo të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit organizon edhe takime shtesë.

Drejtori dhe stafi tjetër profesional përgatisin dhe shqyrtojnë kërkesat për licenca dhe leje, pastaj përmes takimeve të para-bordit bëhet seleksionimi i kërkesave që i plotësojnë kriteret për t'u përcjellë në Bord, në përputhje me ligjet në fuqi.

4.3. Ekzekutivi

Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori dhe Kryeinspektori. Drejtori është përgjegjës për të gjitha çështjet ekzekutive brenda KPMM-së, i cili bënë organizimin e takimeve të bordit, përgatitjen e raporteve sipas kërkesave për mbledhjet e Bordit dhe merret me ekzekutimin e vendimeve të marrura nga Bordi. Bazuar në legjislacionin në fuqi Drejtori ka mandat 3 vjeçar ndërsa Kryeinspektori ka mandat 5 vjeçar.

Menaxhmenti i mesëm në KPMM janë drejtorë të departamenteve dhe janë nëpunës civilë. Sipas ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nëpunësit civilë janë punëtorë të karrierës me afat të pacaktuar.

4.4. Burimet Njerëzore

Me Ligjin Nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, KPMM-së i janë aprovuar 80 pozita. Deri në fund të vitit 2019 KPMM ka arritur t'i plotësojë 76 pozita. KPMM është duke analizuar edhe mundësinë e zvogëlimit të byrokracisë brenda saj përmes një procesi të ristrukturimit organizativ i cili është në proces e sipër.

KPMM ka personel me kuadër të kualifikuar, siç mund të shihet edhe në grafikun në vijim.




Figura 4. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së

Në figurën më poshtë është paraqitur organogrami i KPMM-së.




Figura 5. Organogrami i KPM-së për vitin 2019

Niveli i pagave të stafit në KPMM është i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Anëtarët e Bordit janë staf profesional të emëruar, dhe pagat e tyre janë të përcaktuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Drejtori dhe stafi tjetër ekzekutivë janë nëpunës civilë dhe pagat i kanë të përcaktuara sipas legjislacionit për shërbyes civilë (me koeficientë). Për shkak të natyrës specifike të punës së KPMM-së, përveç pagës bazë, stafi i KPMM-së ka të aprovuara nga MF dhe Kuvendi i Kosovës edhe shtesa në pagë, sipas specifikave të punës për pozita.

Gjatë vitit 2019 një numër i punëtorëve të KPMM-së ka marrë pjesë në trajnime si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Një numër i trajnimeve janë organizuar nga IKAP, por edhe një pjesë e trajnimeve janë organizuar nga institucione tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vetëm detajet e trajnimeve të stafit të KPMM-së gjatë vitit 2019 të realizuara jashtë vendit, ndërsa detajet e pjesëmarrjeve në punëtori dhe konferenca të ndryshme gjatë vitit 2019 janë paraqitur te pjesa e raportimit financiar.

Tabela 3: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2019

Ofruesi i Trajnimit	Lloji i trajnimit	Numri i pjesëmarrësve	Vendi	Kohëzgjatja
BSCK	E-Prokurimi në funksion të zyrtarëve	8	Mali i Zi	4 ditë
ADA Consulting	Përmbartimi i vendimeve dhe procedura sipas mjeteve juridike	5	Maqedoni	4 ditë
IKAP	Qasja në Dokumente Publike	1	Prishtinë	2 ditë
IKAP	Sistemi për mbrojtjen e të dhënave personale	1	Prishtinë	2 ditë
IKAP	Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor të Nismave të Reja Qeveritare	1	Prishtinë	1 ditë
IKAP	Sinjalizuesit dhe e drejta e tyre	1	Prishtinë	2 ditë
IKAP	Përgatitja e projektpropozimeve dhe cikli i menaxhimit të projekteve	1	Prishtinë	7 ditë

4.5. Asetet e KPMM-së

Për kryerjen e aktiviteteve të veta, KPMM ka në posedim një numër të madh të aseteve funksionale si:

- Informacionet gjeoshkencore
- Gjeodatabazën e Kosovës
- Harduerë dhe Softuerë të avansuar
- Pajisje të Logjistikës (vetura) etj.

4.6. Lokacioni i KPMM-së dhe hapësira fizike e objektit

Objekti i zyreve të KPMM-së ndodhet në Breg të Diellit në rrugën Armend Daci, nr.1 në Prishtinë. Më poshtë është paraqitur harta e lokacionit të objektit të zyreve të KPMM-së.



Figura 6. Lokacioni i KPMM-së

Në mungesë të objektit të përhershëm për zyre, KPMM është e obliguar që të merr me qera objekt privat me sipërfaqe prej **1816 m²**.

Edhe pse disa herë KPMM iu ka drejtuar institucioneve përkatëse me kërkesë që të vendoset në objektet e institucioneve publike, ende nuk është bërë një zgjidhje, prandaj KPMM vazhdon të qëndrojë me qera në objekte private, që nga viti 2004.

Vlen të theksohet se gjatë viteve 2010-2019, për hapësirë për zyre me qera KPMM ka shpenzuar nga Buxheti i Kosovës shumën prej **715,543.59 €**, ku gjatë vitit 2019 për zyre me qera KPMM ka shpenzuar **86,071.13 €**.

Gjatë vitit 2017 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi mes MAP-MMPH-KPMM për fillimin e ndërtimit të objektit për zyre të përbashkët për MMPH dhe KPMM. Ka filluar ndërtimi i objektit, dhe është në ndërtim e sipër.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. Shqyrtimi dhe Licencimi

KPMM-se gjatë vitit **2019** ka shqyrtuar gjithsejtë **375** kërkesa për licenca të hulumtimit dhe shfrytëzimit, si dhe kërkesa për Leje për Aktivitete të Veçanta, kërkesa/aplikacione të Hulumtimit kanë qenë **188**, **62** për Shfrytëzim si dhe **125** për Leje të Aktivitete të Veçanta.

KPMM-së në takimet e para Bordit dhe takimet e rregullta të Bordit mbajtura gjatë vitit 2019, KPMM-se gjatë vitit **2019** ka shqyrtuar gjithsejtë **375** kërkesa-aplikacione

- Hulumtimit = **188**
- Shfrytëzimit = **62**
- Leje të Aktivitete të Veçanta = **125**

Përveç kërkesave të pranura gjatë vitit **2019 KPMM**, ka shqyrtuar edhe kërkesat e pranura të viteve paraprake. KPMM-ë gjatë vitit **2019**, ka pranuar gjithsej **304** kërkesa për licenca të hulumtimit dhe shfrytëzimit, si dhe kërkesa për Leje për Aktivitete të Veçanta, prej tyre:

- Kërkesa për Licenca të hulumtimit = **124**
- Kërkesa për Licenca të shfrytëzimit = **58**
- Kërkesa për leje për aktivitet e veçanta = **122** (separacione **59**, bazë betoni **52**, bazë asfalti **4**, Fabrikë sortuese **5**, flotim **2**).

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur numri i aplikacioneve të pranura sipas muajve, gjatë vitit **2019**.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri i aplikacioneve të pranura, gjatë viteve 2015-2019.




Figura 7. Pranimi i aplikacioneve sipas muajve.




Figura 8. Numri i aplikacioneve të pranuar, gjatë viteve 2015-2019

Pas procedimit të të gjitha kërkesave/aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi, janë lëshuar **255** Licenca dhe Leje për aktivitete të veçanta. Prej tyre janë: **85** licenca për hulumtim dhe **52** licenca për shfrytëzim, si dhe **118** Leje për aktivitete të veçanta (bazë asfalti **6**, bazë betoni **15**, separacione **32**, si dhe **2** Fabrikë sortuese) – shih tabelën në vijim.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur nr. i licencave dhe lejeve të lëshuara, gjatë viteve: **2015-2019.**





Figura 9. Numri i licencave dhe lejeve të lëshuara, gjatë viteve 2015-2019

Tabela 4: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2019

Nr. Rendor	Lloji i licencës	Numri i licencave të aprovuara
1	Licenca për hulumtim	85
2	Licenca për shfrytëzim	52
3	Leje për aktivitete të veçanta	118
	Total	255

Ndryshimi në mes të aplikacioneve dhe licencave të aprovuara është se të gjitha kërkesat për licenca dhe Leje për Aktivitete të Veçanta nuk i kanë plotësuar kushtet Ligjore për t'u licencuar.

**Figura 10. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2019**

5.1.1. Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)

Me Licencë për Hulumtim nënkupton autorizimin zyrtar me shkrim të lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës III të LMM-së.

Licenca për hulumtim të mineralet ndërtimore lëshohet në afat jo më shumë se 2 vite. Vlen për një zonë që nuk është më e madhe se 50 ha. Mund të vazhdohet edhe për një periudhë kohore maksimale prej 2 viteve.

Licencat e hulumtimit për të gjitha mineralet tjera lëshohen në afat prej jo më shumë se 3 vite. Vlen për një sipërfaqe jo më të madhe se 100 km², me mundësi vazhdimi për 2 herë, ku secili vazhdim nuk mund të jetë më i gjatë se 2 vite, pas çdo vazhdimi sipërfaqja e hulumtimit duhet të reduktohet për 50%.

Asnjë ndërmarrje nuk mund të mbajë licenca të shumëfishta për hulumtimin e mineraleve ndërtimore që mbulojnë në përgjithësi sipërfaqe më të madhe se 10 km², kurse për të gjitha

mineralet tjera nuk mund të mbajë licenca të shumëfishta që mbulojnë në përgjithësi sipërfaqe më shumë se 300 km².

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i licencave për hulumtim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2019, sipas llojeve të lëndëve minerale.

Tabela 5: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale

Lloji i lëndës minerare	Nr. i licencave
K-2 - shkëmbinj të fortë,	55
M-1 - Mineralet Metalike	15
M-2 - Matriali industrial	9
K-3 - rërë dhe zhavor	6
Totali	85




Figura 11. Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.

KPMM. Në bazë të nenit 59.1 dhe nenit 62 të LMM-së, pas shqyrtimit të aplikacioneve në përputhje me ligjin, Bordi KPMM-së i ka refuzuar disa nga kërkesat për licencim të hulumtimit, për mos-plotësimin e kushteve ligjore. Të gjitha ndërmarrjeve u është dërguar aktvendimi mbi arsyet e refuzimit.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.

Tabela 6: Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale

Lloji i lëndës minerare	Nr. i licencave
Shkëmbinj të fortë,	16
Minerale industrial	3
Minerale Metalike	12
Totali	31




Figura 12. Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.

5.1.2. Licencat e shfrytëzimit

Me “Licencë për Shfrytëzim” nënkupton licenca e lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës V të LMM-së. Licencat për shfrytëzim për të gjitha mineralet, përveç mineraleve energjetike mund të lëshohen me kohëzgjatje maksimale prej 25 viteve me mundësi vazhdimi deri në 25 vite tjera. Licencat për shfrytëzim për mineralet energjetike kanë kohëzgjatje maksimale 30 vite me mundësi vazhdimi edhe për 15 vite të tjera.

Periudha kohore e një licence të shfrytëzimit caktohet sipas rezervave të shfrytëzueshme, projektit të shfrytëzimit dhe sipas dinamikës së shfrytëzimit.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të gjitha licencat për shfrytëzim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2019.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i licencave për shfrytëzim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2019, sipas llojeve të lëndëve minerale.

Tabela 7: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale.

Lloji i lëndës minerale	Nr. i licencave
Shkëmbinj të fortë	32
Rërë dhe zhavor	12
Minerale Metalike	4
Material industrial	2
Thëngjill dhe bitumen	2
Totali	52




Figura 13. Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale

Në bazë të nenit 59.1 dhe nenit 62 të LMM-së, pas shqyrtimit të aplikacioneve në përputhje me ligjin, Bordi KPMM-së i ka refuzuar disa nga kërkesat për licencim të Shfrytëzimit, për mos-plotësimin e kushteve ligjore. Të gjitha ndërmarrjeve u është dërguar aktvendimi mbi arsyet e refuzimit.

- Pezullimi i licencave - Në bazë të procedurave administrative të nenit 9.1 të LMM-së, duke u bazuar edhe në vendimet përkatëse nga institucionet tjera, për ndërmarrjet të cilat nuk kanë arritur t'i ruajnë kualifikimet sipas nenit 9.1 të LMM-së, KPMM ka bërë pezullimin 9 e licencave të shfrytëzimit. Të gjitha ndërmarrjeve u është dërguar aktvendimi mbi arsyet e pezullimit.
- Gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar gjithsej 5 kërkesa për mbylljen e licencave të shfrytëzimit.
- KPMM në bashkëpunim me institucionet e tjera si: MMPH dhe AKP, pas fazës së skadimit të licencave ka bërë rikultivim i zonave të licencave.

5.1.3. Lejet për Aktivitete të Veçanta

Me “Leje për Aktivitete të Veçanta” nënkuptohet leja e lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës VI të LMM-së. Kohëzgjatja dhe fushëveprimi i çdo Leje përcaktohet nga KPMM-ja, në përputhje me LMM, në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtpërdrejt dhe racionale në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të veçanta të autorizuara me Lejen në fjalë.

Në grupin e Lejeve për Aktivitete të Veçanta përfshihen:

(a) Leje për përdorimin e lëndëve plasëse për nevojat e sektorit minerar,

(b) Leje për punë në xehetari:

- Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo i pajimeve ose

(c) Leje për përpunimin e lëndëve të para minerale:

- Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo pajimeve (gurëthyes me separacion, bazë e betonit dhe bazë e asfaltit),
- Përdorimi i kemikateve ose reagjentëve të tjerë, ose

Më poshtë është paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike numri i të gjitha lejeve të lëshuara në vitin 2019 për Leje për aktivitete të veçanta si dhe është bërë krahasimin në formë grafike.

Tabela 8: Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2019 për aktivitete të veçanta

Lloji i lëndës minerare	Nr. i licencave
Sortues	55
Baza e betonit	54
Baza e asfaltit	5
Flotacion Sortues	4
Totali	118




Figura 14. Grafiku i lejeve të lëshuara për vitin 2019 për aktivitete të veçanta.

5.2. Rëndësia e resurseve minerare për vendin

Republika e Kosovës është e pasur me resurse minerale, ku resurset energjetike dhe ato të metaleve me ngjyrë, paraqesin potencial të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm. Mund të veçohen linjiti, mineralet e (plumbit zinkut, argjendit dhe arit), mineralet silikate të nikelit dhe kobaltit, të hekur - nikelit, boksitit, manganit, magnezitit, etj. Shfrytëzimi racional dhe i menaxhuar mirë i këtyre resurseve mund të sigurojë mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe për krijimin e vendeve të punës duke përmirësuar dukshëm edhe gjendjen sociale.

Në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit dhe njëkohësisht dhe në ruajtjen e pasurive minerale natyrore të jo-ripërtëritshme do të kontribuonte edhe shfrytëzimi i resurseve të ripërtëritshme si: resurset ujore, energjisë së erës, energjisë diellore, investimet në efikasitet të energjisë po ashtu dhe materialet me mundësi riciklimi gjithashtu, do të mund të plotësonin një pjesë të kërkesave.

Aktualisht prej shumë lëndëve minerale që posedon Kosova, vitet e fundit në një **formë apo tjetrën janë duke u shfrytëzuar kryesisht këto lëndë minerale:**

- Mineralet metalore (Pb-Zn-Ag, Au, Ni-Co, Cr),
- Mineralet energjetike (Linjiti),
- Mineralet jo-metalore (andezit, gëlqeror, bazalt, dunit, rreshpe, rërë dhe zhavorr, rërë kuarcore, mergelë, argjilë, etj.),

Për shkak të problemeve nga më të ndryshmet ende nuk shfrytëzohen të gjitha lëndët minerale të cilat në vete posedojnë një potencial shfrytëzimi si p.sh. magneziti, boksitet etj.

5.3. Analizë e realizimit të prodhimit të lëndëve minerale

Gjat vitit 2019, si dhe në vitet paraprake, shumica e ndërmarrjeve që merren me shfrytëzimin e shkëmbinjve të fortë, rërës dhe zhavorrit nuk janë duke arritur të përmbushin planifikimet e tyre të prodhimit. Në bazë të analizave të bëra mund të konstatohet se arsyet kryesore për dështim të disa ndërmarrjeve janë:

- Planifikimi jo real i ndërmarrjeve lidhur me shfrytëzimin dhe përpunimin e lëndës minerale.
- Mungesa e kapitalit të ndërmarrjeve për të investuar në fazën e hulumtimit për të evituar dështimin në fazën e shfrytëzimit për shkak të cilësisë së dobët të mineralit.
- Aktivitetet minerare të jashtëligjshme, etj.

5.3.1. Realizimi i prodhimit për lëndë minerale energjetike

Qymyri (linjiti) si mineral energjetik është resursi më i rëndësishëm i Kosovës, ngase furnizimi më energji elektrike pothuajse tërësisht varet nga kjo lëndë minerale. Resurset e vlerësuara të qymyrit në gjithë Kosovën janë rreth 12.5 miliardë tonë, që nga aspektin ekonomik konsiderohen me leverdi për tu shfrytëzuar. Aktualisht pranë KPMM-së për shfrytëzimin e lëndëve minerale energjetike është e licencuar vetëm “Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” e cila bënë shfrytëzimin sipërfaqësor të linjtit për nevojat e prodhimit të energjisë elektrike të vendit.




Figura 15. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme minerale energjetike gjatë viteve 2016-2019





Figura 16. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzuara të mineraleve energjetike (Linjitit) gjatë viteve 2016-2019

5.3.2. Realizimi i prodhimit për lëndë minerale metalore

Shfrytëzimi i lëndëve minerale metalore edhe këtë vit sikurse vitet paraprake nuk ka shkuar sipas planifikimeve të parapara nga ndërmarrjet për shumë arsye, disa nga të cilat janë përmendur më lartë te analiza e sektorit minerar.

Tabela 9: Gjendja e rezervave minerale metalore në vendburimet e licencuara gjatë viteve 2016-2019

Lënda minerale	Përshkrimi	2016	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2017	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2018	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2019	Raporti Planifikim - Shfrytëzim
Pb-Zn	Rezervat e shfrytëzueshme	4,361,985.30	71.96	4,138,612.80	63.93	3,900,036.80	68.29	5,068,591.80	56.13
	Planifikimi	349,382.00		349,382.00		349,382.00		363,605.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	251,405.00		223,372.50		238,576.00		204,079.00	
Ni-Co	Rezervat e shfrytëzueshme	10,438,101.05	27.89	17,443,444.18	52.71	17,011,789.12	29.13	19,602,959.91	20.69
	Planifikimi	1,442,758.00		1,184,879.00		1,481,646.00		1,474,323.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	402,396.94		624,557.87		431,655.06		305,012.48	

**Figura 17. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme të mineraleve metalore në vendburimet e licencuara gjatë viteve 2016-2019**




Figura 18. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale metalore të shfrytëzuara gjatë viteve 2016-2019

5.3.3. Realizimi i prodhimit për lëndë minerale jo metalore

Në tabelat dhe grafikët e më poshtëm është paraqitur sasia e shfrytëzuar sipas lëndëve minerale jo-metalore. Përqindja (%) e realizimit të prodhimit është e bazuar në raportin në mes sasisë së planifikuar të prodhimit dhe realizimit.

Tabela 10: Gjendja e rezervave të mineraleve jo metalore në vendburimet e licencuara 2016-2019

Lënda minerale	Aktiviteti	2016	Raport i Planifikim - Shfrytëzim	2017	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2018	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2019	Raporti Planifikim - Shfrytëzim
Andezite (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	9,856,845.03	2.47	9,782,808.05	18.24	9,664,859.34	33.13	10,069,616.48	52.74
	Planifikimi	652,200.00		406,000.00		356,000.00		291,400.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	16,140.24		74,036.98		117,948.71		153,679.86	
Argjillë (t)	Rezervat e shfrytëzueshme	14,078,849.48	49.09	13,617,929.01	64.31	12,941,391.61	94.39	12,824,583.61	57.16
	Planifikimi	758,061.00		716,741.00		716,741.00		707,661.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	372,113.34		460,920.47		676,537.40		404,532.60	
Gëlqeror (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	170,011,929.68	76.91	191,531,247.73	71.17	198,798,333.95	78.54	209,405,313.84	57.44
	Planifikimi	8,104,936.00		9,124,353.00		8,811,377.00		9,887,637.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	6,233,781.71		6,494,094.47		6,920,075.54		5,679,638.18	

Bazalt (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	1,392,122.13	0.00	1,387,052.95	26.82	1,387,052.95	0.00	1,387,052.95	111.53
	Planifikimi	118,900.00		18,900.00		18,900.00		18,900.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	0.00		5,069.18		0.00		21,079.88	
Rërë dhe zhavorr (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	1,256,690.23	22.86	1,373,052.15	23.22	1,479,619.17	19.20	1,707,453.01	29.63
	Planifikimi	50,480.00		97,800.00		141,688.00		222,336.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	11,542.20		22,712.00		27,201.87		65,888.40	
Rërë kuarcore (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	2,116,296.46	13.53	2,088,393.46	14.64	2,053,822.35	18.14	2,030,139.82	16.84
	Planifikimi	190,600.00		190,600.00		190,600.00		140,600.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	25,782.32		27,903.00		34,571.11		23,682.53	
Dunit (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	5,339,683.94	32.37	6,557,272.53	0.00	6,557,272.53	0.00	6,557,272.53	0.00
	Planifikimi	638,570.70		710,400.00		405,400.00		405,400.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	206,685.04		0.00		0.00		0.00	
Serpentin (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	68,826.00		68,826.00		68,826.00		166,351.83	10.33
	Planifikimi	0.00		0.00		0.00		35,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	0.00		0.00		0.00		3,616.43	
Mërgel (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	18,701,256.00	28.10	19,048,627.50	21.78	19,895,580.00	21.51	44,964,319.70	16.98
	Planifikimi	1,140,000.00		1,435,566.50		1,485,566.50		1,716,335.73	
	Rezervat e shfrytëzuara	320,378.00		312,726.50		319,582.00		291,508.00	
Rreshpe (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	534,605.78	41.97	610,073.78	0.00	608,673.78	4.38	832,649.69	140.61
	Planifikimi	10,000.00		32,000.00		32,000.00		82,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	4,197.22		0.00		1,400.00		115,302.09	
Mermer (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	7,576,778.12	1.09	7,576,212.42	0.39	7,670,813.25	0.44	8,159,070.25	0.03
	Planifikimi	145,000.00		145,000.00		159,400.00		184,400.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	1,575.00		565.70		706.17		55.00	
Gabro (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	1,394,968.00	1.92	1,394,268.00	0.81	1,392,217.50	2.89	1,380,710.86	16.20
	Planifikimi	86,000.00		86,000.00		71,020.00		71,020.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	1,650.00		700.00		2,050.50		11,506.64	
Tuf (t)	Rezervat e shfrytëzueshme	0.00		0.00		22,586.20	0.00	21,761.70	4.04
	Planifikimi	0.00		0.00		20,400.00		20,400.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	0.00		0.00		0.00		824.50	




Figura 19. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme të mineraleve jo metalore 2016-2019




Figura 20. Diagrami i gjendjes së rezervave të shfrytëzueshme të gëlqerorit për vitet 2016-2019




Figura 21. Diagrami i rezervave të shfrytëzuara të lëndëve minerale jo metalore gjatë viteve 2016-2019




Figura 22. Diagrami i rezervave të shfrytëzuara të lëndëve minerale jo metalore (gëlqeror mërgel) gjatë viteve 2016-2019

5.4. Aktivitetet e rikultivimit dhe mbylljes së minierave/guroreve në vitin 2019

Në bazë të vendimit 496/2017 dhe 3667/18, gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar gjithsej 20 kërkesa për mbylljen e licencave të shfrytëzimit. Në pajtim me nenin 63 paragrafi 3 pika 1 dhe 2 të LMM-së, KPMM në bashkëpunim me MMPH dhe AKP, pas fazës së skadimit të licencave ka bërë rikultivim i zonave të licencave.

Tabela 11: Ri kultivimi dhe mbyllja e minierave/guroreve gjatë vitit 2019

	Qellimi i raportit	Nr. Rendor	Emri i ndermarrjes	Lloji i Resursit	Lokacioni	Komuna	Sipërfaqja m ²
	Per zgjatje te afatit te garancioneve	1	N.N.T. "Mirusha Transport" sh.p.k 951	Gelqeror	Gremnik - Kastrati V.P	Kline	55943.5
	Per zgjatje te afatit te garancioneve	2	Tulltorja shpk 819	Argjille	Maqak - Maqak	Prizren	95058.668
Pa rikultivuar	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-negativ	3	"Union Comerc" sh.p.k. 2228	rere dhe zhavorr	Vragovc	Peje	5295.76
Rikultivim me mbyllje	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-pozitiv	4	"ADI - Compani" sh.p.k. 1778	Rere dhe Zhavorr	Hodonovc	Kamenice	4029.676
	Per zgjatje te afatit te garancionit	5	Companya " Eskavatori " Sh.p.k. 2023	Gelqeror	Silovij	Lipjan	51212.688
Rikultivim me mbyllje	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-pozitiv	6	"Besi Comerc" sh.p.k 2321	Rera dhe Zhavorre	Muçivërc	Kamenice	3297.816
Rikultivim me mbyllje	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-pozitiv	7	"Vëllezërit Demiri" SH.P.K 2048	Rera dhe Zhavorre	Dobërqan	Ranilluk	1587.277
Pa rikultivuar	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-negativ	8	AHN Group 624	Baza asfalti	Miradi	Fushe Kosove	14747
Pa rikultivuar	Sipas kerkese per mbyllje-raporti negativ	9	Geoexplore 2275	Shkemb I fort/Gelqeror	Brod, Semaj	qanik, Shterp	48413.98
Rikultivim me mbyllje	Sipas kerkese per mbyllje-raporti pozitiv	10	Emrush 1935	Shkemb I fort/Gelqeror	lvaje	qanik, Shterp	19904.055
Rikultivim me mbyllje	Sipas kerkese per mbyllje-raporti pozitiv	11	Guri 1288	Shkemb I fort/Gelqeror	Koretishtë	Novoberda	49350
Pa rikultivuar	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-negativ	12	"Talku" sh.p.k	Talk	Strellc i eperm	Deqan	12899.961
Pa rikultivuar	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-negativ	13	LB Ekoplani 921	Shkemb I fort/Gelqeror	Shushu Brad	Shtime	30527.117
	zgjatje te afatit te garancioeve	14	N.N.T. "Mirusha Transport" sh.p.k 951	Gelqeror	Gremnik - Kastrati V.P	Kline	55943.5
	zgjatje te afatit te garancioeve	15	Tulltorja shpk 819	Argjille	Maqak - Maqak	Prizren	95058.668
Rikultivim me mbyllje	Sipas kerkese per mbyllje-raporti pozitiv	16	Universal 2162	Shkemb I fort/Gelqeror	Cernill	Gjilan	36737.969
Rikultivim me mbyllje	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-pozitiv	17	"V. Kastrati" sh.p.k	rere dhe zhavorr	Zahaq	Peje	3403.586
	Per zgjatje te afatit te garancioeve	18	"Trasing Group " Sh.p.k.1711	Rere dhe Zhavorr	Korreticë e eperme	Drenas	80815.734
				Aktivitete I veqant, Sortues	Korreticë e eperme	Drenas	75048.168
	Per zgjatje te afatit te garancioeve	19	"Trasing Group " Sh.p.k. 1727				
Pa rikultivuar	Per mbyllje pas skadimit te licences pas rikultivimit- negativ	20	"Xella Kosova" L.L.C	Rere Kuarcore	Silovi	Lipjan	63002.496
	Per zgjatje te garancionit	21	P.T.SH. " Vëllezërit e Bashkuar " Sh.p.k	Shkemb I fort/Gelqeror	Rezina Rezina	Prizren	10000
Pa rikultivuar	Sipas kerkese per mbyllje-raporti negativ	22	Geoexplore 275	Shkemb I fort/Gelqeror	Brod, Semaj	qanik, Shterp	48413.98
	Per mbyllje sipas kerkeseve per lirim-dorezim te licences pas rikultivimit-Ne proces	23	Company "7 Shtatori" sh.p.k 1062	Aktivitete I veqant, Baze asfalti	Kep Kep- Ahishte	Kaqanik	19938.941
Pa rikultivuar	Per mbyllje pas skadimit te licences pas rikultivimit- negativ	24	"Etem Trade" Sh.p.k.	Shkemb I fort/Gelqeror	Zabelji Vrbnicës- Likeni Kuç	Prizren	15535.197
Rikultivim me mbyllje	Sipas kerkese per mbyllje-raporti pozitiv	25	Fraseri I madh 1848	rere dhe zhavorr	Frashër	Mitrovica	13495.422
Rikultivim me mbyllje	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-pozitiv	26	Graniti-F 684	Shkemb I fort/Gelqeror	Priboj	Klllokot	16171.629
Rikultivim me mbyllje	Pas skadimit te licences pas rikultivimit-pozitiv	27	Ma Con 1152	Shkemb I fort/Gelqeror	Cerrcë	Istog	20857.219
	Per zgjatje te afatit te garancioeve	28	N.N.T. "Mirusha Transport" sh.p.k 951	Gelqeror	Gremnik - Kastrati V.P	Kline	55943.5
	Per zgjatje te afatit te garancioeve	29	"KODRA" Sh.p.k.	Dunit	Sankovc	Drenas	129608.992
	Per zgjatje te afatit te garancionit	30	Companya " Eskavatori " Sh.p.k.	Gelqeror	Silovij	Lipjan	51212.688

Në fotot më poshtë janë paraqitur fushat e rikultivuara në ish minierat/guroret



Figura 23. Fushat e rikultivuara në ish minierat/guroret

5.5. Planifikimi dhe nevojat për vitin 2020 - sipas lëndëve minerale

Menaxhimi i resurseve minerale është një aktivitet i integruar i cili identifikon, vlerëson dhe siguron një plan optimal të shfrytëzimit të resurseve minerale, për të prodhuar një produkt cilësor i cili kënaq /plotëson/ objektivat e biznesit të ndërmarrjes por dhe kërkesat e konsumatorit, në një mjedis dinamik.

5.5.1. Analizë e problemeve në planifikimet vjetore në sektorin minerar

Analizimi i nevojave dhe planifikimi për vitin vijues është bërë duke e marr parasysh trendin e shfrytëzimit të katër viteve paraprake 2016 -2019.

Vështirësitë kryesore vërehen të organizimi gjegjësisht strukturimi i dobët i vet ndërmarrjeve duke u përcjellë pastaj me një paqëndrueshmëri zhvillimore dhe financiare. Pra menaxhimi i ndërmarrjeve ende nuk është në nivelin e duhur.

Përfundimisht nga sa u tha më lartë ka edhe ndërmarrje të cilat realizimet i kanë në nivelin e planifikimeve vjetore të prodhimit ku si shembull mund të merret “KEK”-u .

5.6. Planifikimi i prodhimit për lëndë minerale energjetike

Më poshtë është paraqitur tabela e planifikimeve dhe shfrytëzimeve të lëndëve minerale energjetike (linjit) për vitet 2016-2019 me qëllim të nxjerrjes së planifikimit të shfrytëzimit për vitin 2020.

Tabela 12: Planifikimi i shfrytëzimit të rezervave minerale energjetike për vitin 2020

Tabela e planifikimit për shfrytëzim të rezervave minerale energjetike për vitet 2016 - 2019						
Lënda minerale	Aktiviteti	Viti				
		2016	2017	2018	2019	2020
Lignit (t)	Planifikimi	8,400,000.00	8,400,000.00	7,970,000.00	8,400,000.00	8,000,000.00
	Rezervat e shfrytëzuara	8,800,848.00	7,574,697.00	7,169,767.00	8,063,051.00	



Figura 24. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave minerale energjetike (linjtit) për vitin 2020 bazuar në vitet 2016-2019

5.7. Planifikimi i prodhimit për lëndë minerale metalore

Më poshtë është paraqitur tabela e planifikimeve dhe shfrytëzimeve të lëndëve minerale metalore për vitet 2016-2019, me qëllim të nxjerrjes së planifikimit të shfrytëzimit për vitin 2020.

Tabela 13: Planifikimi i shfrytëzimit të rezervave minerale metalore për vitin 2020

Tabela e shfrytëzimit të rezervave minerale metalore për vitet 2016 - 2019 dhe planifikimi per vitin 2020						
Lënda minerale	Përshkrimi	Viti				
		2016	2017	2018	2019	2020
Pb-Zn	Planifikimi	349,382.00	349,382.00	349,382.00	363,605.00	218,000.00
	Rezervat e shfrytëzuara	251,405.00	223,372.50	238,576.00	204,079.00	
Ni-Co	Planifikimi	1,442,758.00	1,184,879.00	1,481,646.00	1,474,323.00	380,000.00
	Rezervat e shfrytëzuara	402,396.94	624,557.87	431,655.06	305,012.48	




Figura 25. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave minerale metalore për vitin 2020

5.8. Planifikimi i prodhimit për lëndë minerale jo metalore

Më poshtë është paraqitur tabela e planifikimeve dhe shfrytëzimeve të lëndëve minerale jo-metalore për vitet 2016-2019 me qëllim të nxjerrjes së planifikimit të shfrytëzimit për vitin 2020.

Tabela 14: Planifikimi i shfrytëzimit të rezervave minerale jo-metalore për vitin 2020

Lënda minerale	Tabela e planifikimit dhe e shfrytëzimit të rezervave minerale jo-metalore për vitet 2016-2019 dhe planifikimi për vitin 2020								
	2016		2017		2018		2019		2020
	Planifikimi	Rezervat e shfrytëzuara	Planifikimi	Rezervat e shfrytëzuara	Planifikimi	Rezervat e shfrytëzuara	Planifikimi	Rezervat e shfrytëzuara	Planifikimi
Andezite (m3)	652,200.00	16,140.24	406,000.00	74,036.98	356,000.00	117,948.71	291,400.00	153,679.86	125,000.00
Argjilë (t)	758,061.00	372,113.34	716,741.00	460,920.47	716,741.00	676,537.40	707,661.00	404,532.60	440,000.00
Gëlqeror (m3)	8,104,936.00	6,233,781.71	9,124,353.00	6,494,094.47	8,811,377.00	6,920,075.54	9,887,637.00	5,679,638.18	5,800,000.00
Bazalt (m3)	118,900.00	0.00	18,900.00	5,069.18	18,900.00	0.00	18,900.00	21,079.88	13,500.00
Rërë dhe zhavorr (m3)	50,480.00	11,542.20	97,800.00	22,712.00	141,688.00	27,201.87	222,336.00	65,888.40	48,000.00
Rërë kuarcore (m3)	190,600.00	25,782.32	190,600.00	27,903.00	190,600.00	34,571.11	140,600.00	23,682.53	27,000.00
Dunit (m3)	638,570.70	206,685.04	710,400.00	0.00	405,400.00	0.00	405,400.00	0.00	25,000.00
Serpentinite (m3)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	35,000.00	3,616.43	2,200.00
Mërgel (m3)	1,140,000.00	320,378.00	1,435,566.50	312,726.50	1,485,566.50	319,582.00	1,716,335.73	291,508.00	301,500.00
Magnezite (m3)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Rreshpe (m3)	10,000.00	4,197.22	32,000.00	0.00	32,000.00	1,400.00	82,000.00	115,302.09	62,500.00
Mermer (m3)	145,000.00	1,575.00	145,000.00	565.70	159,400.00	706.17	184,400.00	55.00	400.00
Gabro (m3)	86,000.00	1,650.00	86,000.00	700.00	71,020.00	2,050.50	71,020.00	11,506.64	7,800.00
Tuf (t)	0.00	0.00	0.00	0.00	20,400.00	0.00	20,400.00	824.50	520.00




Figura 26. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave minerale jo-metalore për vitin 2020 bazuar në vitet 2016-2019




Figura 27. Diagrami i planifikimit të shfrytëzimit të rezervave për gëlqeror dhe mërgelë për vitin 2020, bazuar në vitet 2016-2019

5.9. Përmbledhje e planifikimit sipas grupimit të lëndëve minerale

Planifikimin e prodhimit sipas grupeve të lëndëve minerale në formë të përmbledhur e paraqesim në tabelat e më poshtme.

Tabela 15: Planifikimi i prodhimit të lëndëve minerale energjetike vitin 2020

Planifikimi i shfrytëzimit për vitin 2019 Mineralet energjetike		
Lënda minerale	Planifikimi	Njësia
Linjit	8,000,000.00	t

Tabela 16: Planifikimi i prodhimit të lëndëve minerale metalore për vitin 2020

Planifikimi prodhimit për vitin 2019 Mineralet metalore sipas llojit të vendburimeve				
Lënda minerale	Planifikimi (t)	Përbërja e metalit në %		
		Pb	Zn	Ag (g/t)
Pb-Zn	210,000.00	2.93%	2.93%	36.77
Ni-Co	Planifikimi (t)	Ni	Co	---
	380,000.00	1.10%	0.02%	---

Tabela 17: Planifikimi i prodhimit të lëndëve minerale jo-metalore për vitin 2020

Planifikimi prodhimit për vitin 2020 Mineralet Industriale-Ndërtimore		
Lënda minerale	Planifikimi	Njësia
Andezit	125,000.00	m ³
Argjilë	440,000.00	t
Gëlqeror	5,800,000.00	m ³
Bazalt	13,500.00	m ³
Rërë dhe zhavorr	48,000.00	m ³
Rëra kuarcore	27,000.00	m ³
Dunit	25,000.00	m ³
Mërgelë	301,500.00	m ³
Rreshpe	62,500.00	m ³
Mermer	400.00	m ³
Gabro	7,800.00	m ³
Tuf	520.00	m ³

5.10. Inspektimi dhe monitorimi i aktiviteteve minerare

Inspektorët e Inspektoratit të Minierave, në pajtueshmëri me ligjin, rregulloret, dispozitat ligjore, standardet dhe normativat teknike, monitorojnë në mënyrë të pavarur:

- Hulumtimin, shfrytëzimin dhe aktivitetet e veçanta të resurseve minerale në Republikën e Kosovës.
- Vlerësimin e mineraleve të shfrytëzuara nga minierat dhe guroret për kalkulimin e Rentës Minerare.
- Zbatimin e masave të sigurisë e mbrojtjes në punë.
- Zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimtarinë minerare .
- Inspektimet e lëndimeve me fatalitet (vdekjeprurëse) dhe lëndimeve të rënda, si dhe dëmet mjedisore ose dëmtimi i pronës dhe masat të cilat është e nevojshme të ndërmerren.
- Inspektimet e fushave paraminuese për minim masiv të përgatitura sipas projektit të shfrytëzimit, për të konstatuar përputhshmërinë e parametrave teknik në aplikim.
- Inspektimet e minimumit dhe marrja e masave për minim të sigurt duke i zbatuar të gjitha masat e sigurisë dhe rregullat e parapara për minim masiv.
- Lëshimi i lejeve për transfer të eksplozivit nga depot kryesore të eksplozivit të minierave nëntokësore dhe mirëmbajtja e shënimeve për gjendjen e sasisë së eksplozivit.
- Inspektimet e rregullta në minierat nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe objektet për përpunimin e pasurimin e lëndës së parë minerale.
- Inspektimet e rregullta vjetore të ndërmarrjeve të licencuara sipas UA.Nr.02/2016 (për mbikqyrjen dhe inspektimin e bartësve të licencave që ushtrojnë aktivitet minerar).
- Ndërprerja e aktiviteteve minerare nëse këto aktivitete nuk kryhen në pajtim me ligjet, rregulloret, dispozitat ligjore, standardet dhe normativet teknike.
- Inspektimet e aktiviteteve minerare të jashtëligjshme dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e tyre.
- Koordinimi i inspektimeve me institucionet tjera.

5.10.1. Organizimi i Inspektoratit

Inspektorati i Minierave është i organizuar të mbikëqyrë gjithë teritorin e Republikës së Kosovës, nga Inspektorët e Xehtarisë, Gjeologjisë, Makinerisë, Elektros dhe Kontrollit të Kualitetit, me këtë renditje:

- **Rajoni i Prishtinës**
- **Rajoni i Prizrenit**
- **Rajoni i Pejës**
- **Rajoni i Gjilanit**
- **Rajoni i Mitrovicës**
- **Për Nëntokësore**
- **Për Sipërfaqësore**
- **Për Eksplozive**
- **Për Makineri dhe Elektrikë dhe**
- **Për Kontrollë të kualitetit**

5.10.2. Zhvillimi i aktiviteve minerar në KEK

Planifikimi dhe realizimi i qymyrit Janar-Dhjetor 2019 (në ton)

Gjatë vitit 2019 KEK-u ka planifikuar shfrytëzimin-nxjerrjen e qymyrit në sasinë prej 7,970,000 ton, ndërsa realizimi është bërë në sasinë prej 8,063,051 ton, apo në përqindje 101,2%.

Qymyri është nxjerrë nga miniera e re “Sibovc Jug – Perëndim”.

Tabela 18: Planifikimi dhe realizimi i qymyrit Janar-Dhjetor 2019 (në ton)

Tab.1	Planifikimi	Realizimi
JANAR	700,000.00	664,262.00
SHKURT	680,000.00	797,743.00
MARS	710,000.00	807,150.00
PRILL	660,000.00	788,368.00
MAJ	650,000.00	525,283.00
QERSHOR	600,000.00	421,452.00
KORRIK	590,000.00	504,585.00
GUSHT	590,000.00	580,243.00
SHTATOR	690,000.00	758,095.00
TETOR	700,000.00	758,574.00
NENTOR	700,000.00	854,704.00
DHJETOR	700,000.00	602,592.00
Totali	7,970,000.00	8,063,051.00

Më poshtë janë paraqitur të dhënat e planifikimit dhe realizimit të qymyrit për periudhën Janar – Dhjetor – 2019 edhe në formë diagrami.




Figura 28. Planifikimi dhe realizimi i qymyrit për vitin 2019(në ton)

Gjatë vitit 2019 KEK-u ka planifikuar largimin e masave të djerrinës (zbulimin e qymyrit) në sasinë prej 12,500,000.00 m³ ndërsa realizimi është bërë në sasinë prej 11,139,541.00m³ apo në përqindje 89,1% .

Pas përfundimit të procesit mjaft të komplikuar të shpronësimit, procesi i largimit të djerrinës është në përmissim dhe shkon drejt normalizimit të arritjes së planifikimeve të zbulimit të rezervave të qymyrit.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur planifikimi dhe realizimi i djerrinës për periudhën Janar – Dhjetor 2019 (në metër kub m³):

Tabela 19: Planifikimi dhe realizimi i djerrinës (mbulesës) për periudhën Janar – Dhjetor 2019 (m3)

	Planifikimi	Realizimi
JANAR	1,025,000.00	690,671.00
SHKURT	1,005,000.00	787,476.00
MARS	985,000.00	887,334.00
PRILL	985,000.00	1,009,584.00
MAJ	935,000.00	841,824.00
QERSHOR	840,000.00	867,235.00
KORRIK	1,255,000.00	1,230,593.00
GUSHT	1,405,000.00	899,317.00
SHTATOR	1,015,000.00	1,083,135.00
TETOR	835,000.00	1,334,679.00
NENTOR	1,115,000.00	765,848.00
DHJETOR	1,100,000.00	741,845.00
Total	12,500,000.00	11,139,541.00

Më poshtë janë paraqitur të dhënat e planifikimit dhe realizimit të djerrinës për periudhën Janar – Dhjetor 2019 edhe në formë diagrami:




Figura 29. Planifikimi dhe realizimi i djerrinës (m³)

5.10.3. Sasia e eksplozivit e përdorur gjatë vitit 2019

Në vitin 2019 sasia e eksplozivit e hargjuar në total për miniera nëntokësore është:

$$S=210,721.20 \text{ (kg)},$$

dhe sasia e eksplozivit e hargjuar për miniera sipërfaqësore është:

$$S=2,845,411.00 \text{ (kg)}$$

Dhe se si përfundim i sasia e masese vëllimore e miniuar në miniera sipërfaqësore është :

$$V= 6,081,769.69 \text{ m}^3.$$

dhe konsumi specifik për m^3 është:

$$Q=0.46 \text{ (kg/m}^3 \text{)}$$

Po ashtu vlen të theksohet edhe prodhimtaria e eksplozivit nga ndërmarrjet prodhuese të R.së Kosovës e cila si sasi është:

$$S=1,490,015.00 \text{ (kg)}$$

Tabela 20: Minimet speciale të realizuara gjatë vitit 2019 :

Nr. i minimeve	Qëllimi i minimit
1	Kyqje në etazha të minierës
3	Per Vendosje te Makinerisë
67	Trase të rrugëve, për energji të erës dhe hidrocentraleve

Koment: Bazuar në kërkesen nga Anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri që të elaborojmë ndikimin e përdorimit të eksplozivëve në rrethinë, me komoditet përgjegjemi se përpos një rasti në fshatin Qirez ku kemi pasur hudhje të pakontrolluar të shkëmbinjëve në raste e tjera nuk kemi asnjë ankesë nga komuniteti. Edhe për rastin e lartcekur kemi marrur masa administrative me qëllim që të mos na përseritet ndonjë rast i ngjajshëm dhe se për këtë është edhe raporti i komisionit me Nr. protokoli 2306 i datës 28.03.2019 i mbrojtur nga Kryeinspektori i minierave në Komisionin Parlamentar dhe i gatëshëm për prezantim sa herë të kërkohet.

5.10.4. Mbrojtja dhe siguria në punë

Raporti i lëndimeve/Aksidenteve gjatë vitit 2019 në minierat e Trepçës, minierat sipërfaqësore, gurore dhe objekte përpunuese

Gjatë vitit 2019 në industrinë minerare (në minierat e Trepçës, minierat sipërfaqësore, gurore dhe objekte përpunuese) kanë ndodhur disa aksidente me fatalitet, lëndime të rënda dhe të lehta.

Në vijim paraqiten pasqyrat tabelore të aksidenteve - lëndimeve në punë *gjatë vitit 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019.*

Tabela 21: Aksidentet - lëndimet në punë në miniera gjatë vitit 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019 sipas llojit të lëndimeve

Lloji i lëndimeve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Fatalitet	0	0	0	0	3
Lëndim kolektiv	0	0	0	0	0
Lëndim i rëndë	4	3	0	5	6
Lëndim i lehtë	72	61	70	76	83

Raportin e lëndimeve duke i krahasuar në pesë vite po e pasqyrojmë me diagram




Figura 30. Paraqitja grafike sipas llojit të lëndimeve

Raportin e lëndimeve duke i krahasuar në pesë vite po e pasqyrojmë me diagram

Tabela 22: Aksidentet - lëndimet në punë në miniera, gurore, objekte minerare gjatë vitit 2019

Lloji i lëndimeve	Minierat Nëntokësore "Trepça" 2019	KEK 2019	New CO Ferronickeli 2019	Sharr Cem 2019	Guroret 2019	TOTAL 2019
Lëndime me Fatalitet	0	0	0	0	3	3
Lëndim kolektiv	0	0	0	0	0	0
Lëndim i rëndë	5	0	0	0	1	6
Lëndim i lehtë	77	6	0	0	0	83




Figura 31. Paraqitja grafike e lëndimeve sipas punishteve

Aksidentet me fatalitet gjatë vitit 2019 kanë qenë si në vijim

1. Afrim Gashi, I aksidentuar më 21.03.2019 në guroren "Mirusha Company" sh.p.k (Lic. Shfr. 1263), Dollc, Klinë;
2. Nezir Hakaj, I aksidentuar më 05.11.2019 në Bazën e Betonit "Alko Beton" B.I, (Apl. 1079), Milloshevë, Obiliq;
3. Salih Koraçi, I aksidentuar më 28.11.2019 në guroren "Guri I Bekuar" sh.p.k (Lic. Shfr. 1942), Seqishtë, Hani I Elezit.

Pas analizimit të raporteve mbi këto aksidente me fatalitet rrjedh konkludimi se duhet shtuar masat e mbrojtjes dhe vetëdijesimit në punë tek ndërmarrjet e licencuara.

Lëndimet e Rënda gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019 në minierat nëntokësore dhe gurore kemi këto lëndime të rënda të raportuara:

- 1- lëndim i rëndë në minierën "Trepça" Stan Tërg;
- 4- lëndime të rënda në minierën "Trepça"- Artanë-Kizhnicë;
- 1- lëndim I rëndë në Guroren "Guri" Viti.

Përfundime lidhur me lëndimet në punë

Krahas ngritjes profesionale dhe të përgjegjësisë në industrinë minerare kemi ngritje në sferën e sigurisë. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e caktimit të personave përgjegjës nëpër kompani në bazë të Udhëzimit Administrativ të KPMM-së dhe se plotësimi i tij sipas rekomandimeve tona do e rris efikasitetin në punë dhe sigurinë në gurorë. Krahas kësaj mendojmë se UA i miratuar për persona përgjegjës që të jenë me kontratë pune tek këto ndërmarrje do ta rris kujdesin në aktivitetet minerare sa i përket sigurisë minerare.

Nevojitet vazhdimi i mëtejshëm i aftësimeve profesionale të personelit tekniko-minerar, licencimin e malnipesuesve të makinave të rënda, delegimin e përgjegjësisë, shtimin e mbikëqyrjes në zbatimin e masave teknike e të sigurisë, përmirësimin e kushteve të punës, aplikimin i masave ndëshkuese ndaj personave fizik dhe juridik.

Shkaktarët më të shpeshtë të aksidenteve dhe avarive në miniera dhe objektet përpunuese minerare janë si në vijim:

- Gjendja jo e mirë teknike e pajisjeve dhe stabilimenteve tekniko – teknologjike dhe manipulimi jo adekuat me këto stabilimente,
- Gjendja e shkallëve në minierat sipërfaqësore (këndet dhe lartësitë e shkallëve punuese dhe këndi gjeneral),
- Pakujdesia dhe neglizhenca e punëtorëve,
- Përdorimi i pamjaftueshëm i mjeteve personale mbrojtëse,
- Mungesa e njohurive dhe aftësimi i pamjaftueshëm profesional.

Koment: Përgjegjësit e Komisionit parlamentar lidhur me zbatimin e Ligjit për siguri në punë i gjeni në bashkpjesmarrjen e Inspektoratit për hartimin e rregulloreve që tash më janë në fuqi. Jemi në pritje të përpilimit të një rregullorje për Certifikimin e minandezësve dhe përdorimin e eksplozivëve, kërkesë kjo e dërguar në MPB-Departamentin për Siguri Publike.

Ndërsa lidhur me sfidat e zbatimit të këtij ligji konkludoj se nga numri i vogël i Inspektoratit e kemi të pamundur përcjelljen e zbatimit të këtij ligji në përpikmëri, dhe se Inspektorati lajmërohet vetëm kur kemi aksidente të rënda apo me fatalitet.

6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET

6.1. Parandalimi dhe Ndalimi i operimeve të jashtëligjshme dhe ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë

Praktika ka treguar se parandalimi dhe ndalimi i operimeve të jashtëligjshme minerare kërkon bashkëveprim ndërinstitucional dhe se; pa një koordinim të tillë KPMM e ka të vështirë realizimin e qëllimit për ndalimin dhe parandalimin e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare.

6.1.1. Bashkpunimet me Institucionet e vendit:

- Bashkpunimi ndërinstitucional në parandalimin dhe ndalimin e operimeve të jashtëligjshme edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar me zyrtarët nga Drejtoritë e inspektorateve komunale, Policinë e Kosovës, Departamentin e Hetimeve të Krimeve të Rënda, me këtë rast është mbajtur Puntoria për prezentimin e Udhëzuesit për miradministrimin e aktiviteteve minerare dhe mjedisore 15.11.2019.
- Gjatë vitit 2020 KPMM do të vazhdojë me Planin operativ për parandalimin e operuesve të jashtëligjshëm në sektorin minerar. Është ngritur në nivel shumë të lartë bashkëpunimi në mes inspektoriateve të KPMM-së, APK-së, MMPH-së dhe Komunave në parandalimin e operatorëve

6.1.2. Sfidat që na kanë përcjellur gjatë vitit 2019

- Mos efikasiteti i organeve të drejtësisë në shqyrtimin e kallëzimeve penale të proceduara në gjykata nga ana e KPMM-së;
- Ndëshkimet relativisht të ulëta nga gjykata e operuesëve të jashtëligjshëm, ashtu siç parashihet në nenin 80 të Ligjit për Miniera dhe Minerale;
- Mos ndalimi në komunikacion i operuesëve (transportuesëve) të jashtëligjshëm dhe kontrolli i prejardhjes së materialit, nga ana e Policisë së Kosovës;
- Dhënia e tenderëve nga Komunitet dhe Ministrinë përkatëse, për përdorimin e materialit në infrastrukturë pa pasur dëshmi për preardhjen e atij resursi.
- Sfidë në vete paraqitet edhe çështja e garancioneve bankare. Në rastet kur sipërfaqja e paraqitur në aplikacione është me kulturë mal dhe ju kërkohet garancion bankar nga KPMM-ja sipas LMM dhe nga APK-ja për ri kultivim, dhe gjithashtu edhe çmimi dallon për njësi/hektar.
- Sfidë tjetër gjatë vitit 2019 KPMM-ja ka pasur çështjen e tërheqjes së mjeteve për rikultivim nga Kompanitë e sigurimeve në rastet kur ndërmarrjet nuk e kanë kryer rikultivimin e sipërfaqeve pas skadimit të licencave apo lejeve, dhe tani kompanitë e

sigurimeve nuk i aprovojnë kërkesat e KPMM-së, për kthim të mjeteve për rikultivim ashtu si është paraparë me LMM-në;

Andaj, KPMM rekomandon marrjen e këtyre masave:

- Rritjen e efikasitetit në gjykata për të përshpejtuar trajtimin e lëndëve të kallëzimeve penale për operuesit e pa licencuar.
- Marrjen e vendimit me të cilën obligohet Policia e Kosovës që të kontrollojë transportuesit e lëndëve minerale për kontroll, për verifikim e licencës valide.
- Dhënia e kontratave për ngritjen e pendave, të shoqërohet me një njoftim paraprak për ne si KPMM, pasi që në këto raste kemi keqpërdorim të resursit mineral gjatë implementimit të atij projekti.
- Mosdhënia e tenderëve nga Komunitet dhe Ministrinë përkatëse, për përdorimin e materialit në infrastrukturë pa pasur dëshmi për preardhjen e atij resursi.
- Duhet të bëhet harmonizimi i dispozitave ligjore apo nënligjore. Ligji për Tokat Bujqësore, Ligji për Pyjet, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, duhet të harmonizohen me obligimet që dalin nga legjislacioni i BE. Ligji për Pyjet duhet të harmonizohet me LMM-në në mënyrë që mos të kërkojnë Garancione të dyfishta, një nga KPMM dhe një nga APK;
- Një numër i madh i operatorëve të jashtëligjshëm janë duke punuar me energjinë elektrike. Edhe pse këta operatorë mund të jenë të rregullt me pagesa të energjisë së shfrytëzuar, propozojmë që këta operatorë të largohen nga rrjeti elektrik dhe se kyqja me energji elektrike të bëhet vetëm për ata operatorë që marrin licencë për shtrimin e aktiviteteve minerare nga KPMM. Kjo e drejtë del edhe nga Ligji i Inspektoratit të Mjedisit, Ujrave, Natyrës, Planifikimit Hapsinor dhe Ndërtimit Nr. 04/L-175, neni 44, i cili thotë:

Ndërprerja e përkohshme e veprimtarisë

1. Nëse gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive, Inspektori konstaton parregullsi që e rrezikojnë jetën, shëndetin, mjedisin dhe rastet tjera të përcaktuara me ligj, përkohësisht do të ndërpres kryerjen e veprimtarisë me vulosjen-blombimin, vendosjen e shiritit hapësirave, objekteve, kantierëve, pajisjeve, mjeteve të punës dhe mjeteve tjera, deri në mënjanimin e parregullsive.

2. Në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni, inspektori në bashkëpunim me organet kompetente urdhëron personat juridik të cilët kryejnë shërbime publike të furnizimit me ujë, rrymë elektrike dhe të ngjashme t'i ndërprej shërbimin subjektiv të mbikëqyrjes.

- Aktivitet të shtuar dhe pse jo edhe nxitës të operimeve të jashtëligjshme bëjnë ndërmarrjet e prodhimit të elementeve të ndërtimit, e ku si lëndë të parë e kanë argjilën, rërën dhe zhavorrin. Këto ndërmarrje nuk janë të licencuara nga KPMM, sidomos ato që merren me përdorimin e argjilave por edhe ato që merren me prodhimin e elementeve të betonit.

Andaj e bënë të vështirë parandalimin e operimeve të jashtëligjshme si dhe inkurajojnë operatorët e jashtëligjshëm, prandaj licencimi i tyre do të krijonte një bazë për parandalimin e operimeve të jashtëligjshme. Po ashtu në këtë rast mendojmë se edhe kontrolla nga ATK për caktimin e prejardhjes së materialit do të ndihmonte në mos nxitjen nga ana e këtyre ndërmarrjeve që i bëhet operatorëve të jashtëligjshëm.

- Resurset minerale si një pasuri e vendit, duhet të mbrohen dhe të mos bllokohen duke ngritur mbi to apo në afërsi të tyre objekte të ndryshme infrastrukturore apo të tjera. Këtu të gjitha institucionet përkatëse dhe aktorët tjerë që lidhen me sektorin minerar duhet të gjejnë zgjidhjet më të mira në favor të shfrytëzimit racional të resurseve minerare.
- Në këtë vazhde interesi për tokën (land conflict) që tani është shumë serioz (p.sh. vështirësitë që e presin minierën e qymyrit me fshatrat përreth), në të ardhmen e afërt pritet të jetë edhe më i ashpër gjë që mund të paraqiten pengesa serioze për zhvillimin e sektorit minerar. Po kjo problematik i përcjell shumë lëndë tjera minerale, pronarë, ndërmarrje, institucione etj.
- Planifikimin të cilin janë duke e bërë ndërmarrjet në shfrytëzimin e lëndës minerale është në mos përputhje të madhe me realizimin. Në vitin vijues KPMM-ja, MZHE-ja dhe institucionet tjera relevante duhet të përcjellin me kujdes këtë dukuri dhe të analizojnë të gjithë parametrat e nevojshëm pse po ndodhë kjo mospërputhje.

Ndonëse gjatë këtij viti ka pasur rezultate të mira, Inspektorati i Minierave, në bashkëpunim me institucionet tjera do të vazhdojë në parandalimin dhe ndalimin e operimeve të jashtëligjshme në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës.

6.2. Ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë në operimet minerare

Edhe pse funksionimi i sektorit minerar në Kosovë shoqërohet me siguri të mirë, prapë se prapë për Inspektoratin e Minierave mbetet sfida që në bashkëpunim me institucionet relevante të përvetësojë dhe zbatojë standardet teknike dhe të sigurisë që zbatohen në vendet e BE-së si:

- Promovimi i kulturës për siguri dhe mbrojtje në punë;
- Zbatimi rigoroz i masave të mbrojtjes dhe sigurisë në parandalimin e aksidenteve dhe avarive në minierat me shfrytëzim sipërfaqësor dhe nëntokësorë;
- Sigurimi i sistemit efikas të monitorimit të inspektimeve dhe hetimeve në rastet e aksidenteve dhe avarive në punë dhe evidentimi i rregullt i tyre deri te procedimi i këtyre lëndëve në gjykata;

6.3. Mostrajtimi në kohë i lëndëve të paraqitura në gjykata.

Sanksionet Penale të Shqiptuara nga Gjykatat nuk po e arrijnë efektin e preventivës në ndalimin e operimeve të jashtëligjshme. Sa i përket funksionimit dhe zbatimit të legjislacionit në përgjithësi, për fushën e minierave nder të tjera për ne kanë qenë dhe mbetën këto sfida:

- Çështja e vonesës së shqyrtimit të lëndëve nga gjykata kompetente për veprime të pa licencuara nga KPMM-ja, duke i shtyrë seancat nga disa herë deri në vjetërsimin e lëndëve dhe në këtë mënyrë ka krijuar humbje të kohës së stafit për të shkuar deri në gjykata si dhe krijim të shpenzimeve financiare të panevojshme. Masat që merr Gjykata nuk janë në përputhje me dëmin e shkaktuar nga operuesit e pa licencuar, ashtu si parashihet me LMM.
- Pastaj mos zbatimi i dispozitave ligjore për sekuestrim të materialit/mjeteve të punës që hasen në vendin e ngjarjes përkatësisht duke operuar në mënyrë të pa licencuar. Kemi bërë përpjekje disa here që të gjejmë përkrahje nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, për të kryer sekuestrimin e materialit/makinerisë, ashtu siç parashihet me nenin 70 të LMM-së, por nga kjo Agjenci mendojmë se na është kërkuar pa të drejtë vendimi i gjykatës për sekuestrim të mjeteve të punës;
- Mos efikasiteti i Gjykatave në arkëtimin e obligimeve financiare ndaj debitorëve të KPMM-se, sipas propozimeve për përmbarim në lidhje me lëndët e viteve paraprake.
- Përsëritja në vazhdimësi e veprave penale nga të njëjtat operues të jashtëligjshëm;
- Sekuestrimi i mineraleve dhe makinerisë;
- Mbledhja e të hyrave/borxheve nga ndërmarrjet më aktivitet minerare;
- Dëmtimi i konkurrencës nga aktivitetet minerare të jashtëligjshëm;
- Buxheti i pa mjaftueshëm për kryerjen e aktiviteteve të KPMM-së, veçanërisht në kompletimin e stafit.

7. RAPORTIMI FINACIAR

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2019 ka qenë i ndarë në këto 4 (katër) linja buxhetore si më poshtë.

Tabela 23: Buxheti i aprovuar ne fillim te vitit 2019

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2019
1	Paga dhe Mëditje	833,475.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	386,281.00 €
3	Komunali	30,600.00 €
4	Subvencione dhe Transfere	- €
5	Projekte Kapitale	159,000.00 €
	Totali i Aprovuar	1,409,356.00 €




Figura 32. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2019

Buxheti përfundimtar i KPMM-së për vitin 2019, është si në tabelën e më poshtme.

Tabela 24: Buxheti pas rishikimit per vitin 2019

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2019
1	Paga dhe Mëditje	796,061.47 €
2	Mallra dhe Shërbime	386,281.00 €
3	Komunali	30,600.00 €
4	Subvencione dhe Transfere	- €
5	Projekte Kapitale	89,000.00 €
	Totali i Aprovuar	1,301,942.47 €




Figura 33. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2019

Ky ndryshim i buxhetit është bërë më rishikim të buxhetit.

Tabela 25: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2019

Nr. Ren.	Përshkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Ndryshimi	Ne %
1	Paga dhe Mëditje	796,061.47 €	792,642.37 €	3,419.10 €	99.57
2	Mallra dhe Shërbime	386,281.00 €	375,849.06 €	10,431.94 €	97.30
3	Komunali	30,600.00 €	27,811.64 €	2,788.36 €	90.89
4	Subvencione	- €		- €	#DIV/0!
5	Projekte Kapitale	89,000.00 €	68,906.00 €	20,094.00 €	77.42
	Totali i Aprovuar	1,301,942.47 €			
	Totali i Shpenzuar		1,265,209.07 €		
	Totali i Mbetje			36,733.40 €	
	Totali në %				97.18




Figura 34. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2019

Në tabelën e më poshtme janë prezantuar Shpenzimet për paga dhe mëditje, Pagat neto, tatimi, dhe kontributet pensionale të punëtorit dhe punëdhënësit.

Tabela 26: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudh të vitit 2019.

Nr. Ren.	Pershkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Diferenca	Ne %
1	Pagat Neto	654,035.57	652,182.44	1,853.13	99.7
2	Tatimi ne Paga	51,000.00	50,108.27	891.73	98.3
3	Kontributi i Puntorit	37,300.00	36,962.88	337.12	99.1
	Kontributi i Pudhensit	37,300.00	36,962.88	337.12	99.1
4	Pagesa per Vendime Gjyqsore	16,425.90	16,425.90		100.0
	Total	796,061.47	792,642.37	3,419.10	99.6




Figura 35. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2019

